



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/7
Nr. _____/Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 556, datë 28.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË DHE TË KURRIKULËS ME ZGJEDHJE, TË
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe të urdhrimit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Gjuhë shqipe”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Letërsi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

5. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Kimi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë dhe klasën e dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Programet mësimore të klasës së dhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
18. Programet mësimore të klasës së njëmbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
19. Programet mësimore të klasës së dymbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2028 – 2029.
20. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI





**PROGRAMI I LËNDËS “QYTETARI”
ARSIMI I MESËM I LARTË
KLASA 10
FUSHA “SHKENCAT SHOQËRORE”**

Koordinator: Astrit Dautaj



PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	4
2	PËRMBAJTJA E KURRIKULËS SË LËNDËS SË QYTETARISË.....	7
2.1	KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE	8
2.1.1	VLERAT.....	8
2.1.2	QËNDRIMET	10
2.1.3	AFTËSITË	12
2.1.4	NJOHURITË DHE TË KUPTUARIT KRITIK	16
2.2	DIMENSIONET E QYTETARISË DEMOKRATIKE	18
3	REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE NË KLASËN E DHJETË	21
4	UDHËZIME METODOLOGJIKE	95
5	ÇFARË KËRKOHEM NGA MËSUESI I LËNDËS SË QYTETARISË?	96
5.1	Mjedisi i të nxënimit të qytetarisë demokratike.....	98
5.2	Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare	100
5.3	Koha mësimore për tematikë për secilën klasë	103

5.4	Vlerësimi në lëndën e edukimit qytetar: njohuritë, aftësitë dhe prirjet qytetare	104
5.4.1	Aftësitë intelektuale	105
5.4.2	Aftësitë pjesëmarrëse	109
5.4.3	Prirjet qytetare.....	112
6	MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE	115

1 HYRJE

Edukimi për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ) është pjesë e politikës arsimore në Shqipëri, në përmbushje të synimit të saj bazë në drejtim të krijimit të një kulture demokratike dhe pajisjes së individëve me kompetenca për jetën. Në themel të tij qëndrojnë kompetencat për kulturën demokratike të Kornizës Referuese të Këshillit të Evropës, e mbështesin të gjitha kurrikulat e edukimit qytetar, pjesë e kurrikulës zyrtare të arsimit parauniversitar për klasat 1-10. Këto kompetenca janë baza për ndërtimin e përmbajtjes së lëndës së qytetarisë. Ato shprehen dhe nënkuptohen shprehimisht në fushat, dimensionet, idetë, konceptet, objektivat etj., e kësaj kurrikule, të cilat janë të përafruara horizontalisht dhe vertikalisht me standardet dhe praktikrat e KE.

Ndryshimet e përshtatura me kurrikulën ekzistuese shënojnë progres dhe janë në përputhje me politikën dinamike të KE-së të njëzet viteve të fundit. Kurrikula e shkruar pasqyron konceptet dhe praktikrat e përditësuara të dokumenteve të KE. Kurrikula e qytetarisë është në përputhje me konceptet, praktikrat dhe pritshmëritë e KE të EQD/EDNJ, pasi ato përfshijnë koncepte të parashikuara në Kartën e KE.

Përmbajtja e lëndës “Qytetari” trajton jo vetëm realitetin shqiptar, si të ndryshuar dhe ende në ndryshim, problemet dhe sfidat përkatëse, por edhe realitetin evropian dhe global. Si e tillë, kurrikula e kësaj lënde është përbalhur vazhdimisht me sfida si: ndryshimi i faktorëve lokalë, ekonomikë, socialë, kulturorë, por edhe nga këndvështrimi i angazhimit të vendit për integrim dhe anëtarësimin e tij të ardhshëm në BE.

Situata ndërkombëtare dhe nevoja për përmirësimin e cilësisë së Edukimit për qytetari demokratike

Për shumë vite, Evropa përballet me kërcënime që minojnë kulturën e demokracisë, vlerat dhe parimet e saj, të tilla si: rikthimi i luftës, radikalizmi, dobësimi i angazhimit për lirinë e shprehjes, diskriminimi në rritje, gjuha e urrejtjes në internet dhe pakënaqësia me përpjekjet e qeverisë për të trajtuar ndryshimet klimatike. Vitet e fundit ka pasur një rritje të intolerancës ndaj atyre që perceptohen si të ndryshëm, ndaj kulturave dhe gjuhëve të tyre dhe një rënie të interesit për integrimin e pakicave dhe emigrantëve. Kësaj gjendjeje komplekse i shtohet ardhja e sferës digjitale dhe teknologjive të tilla si inteligjenca artificiale gjeneruese, të cilat ofrojnë mundësi të paprecedentë, por gjithashtu përmbajnë rreziqe të konsiderueshme nëse përdoren në mënyrë të papërshtatshme.

Nga ana tjetër arsimit vazhdon të mos arrijë qëllimin e tij për përgatitjen e të rinjve për të jetuar si qytetarë aktivë në një shoqëri demokratike, pavarësisht nga pranimi se vlerat demokratike janë komponentë themelorë dhe thelbësorë si për zhvillimin profesional dhe personal, ashtu dhe për funksionimin demokratik të institucioneve. Për më tepër, nxënësit nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme për t'u fuqizuar dhe për të përfutur plotësisht nga një arsimim që i përgatit ata për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të informuar për shkak të mungesës së kurrikulave fleksibël dhe mjediseve të të mësuarit të sigurt dhe jo të dhunshëm, të favorshëm për të mësuar praktikën demokratike. Përveç kësaj, jo të gjithë nxënësit në Evropë janë në gjendje të kuptojnë dhe të mendojnë në mënyrë kritike për çështje të tilla si historia, bota, politika, ligji, të drejtat e njeriut, kulturat, fetë, media, ekonomia, shkenca dhe mjedisi.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, arsimit, ndër të tjera, duhet të rigjallërojë misionin e tij qytetar duke i përgatitur të gjithë qytetarët që të bëhen pjesëmarrës aktivë në një shoqëri demokratike. Qytetarëve të të gjitha moshave duhet t'u jepet mundësia të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për bashkëjetesën demokratike. Kjo bëhet në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe përmes një qasjeje me shumë palë, duke përfshirë mbështetjen e menaxherëve të arsimit, mësuesve, nxënësve dhe partnerëve të tjerë në arsim.

Transformimi digjital, i mbështetur kryesisht nga Inteligjenca Artificiale (AI), ka ndryshuar ndjeshëm peizazhin arsimor në vitet e fundit. Ky transformim dëshmohet nga integrimi i teknologjive dhe praktikave digjitale për të përmirësuar proceset e të mësuarit, për të zgjeruar aksesin në burimet arsimore, për të promovuar shkrim-leximin digjital dhe për të nxitur qasje inovative që përmirësojnë rezultatet arsimore dhe përgatisin nxënësit për epokën digjitale. Sistemet arsimore kanë nisur reformat në lidhje me rishikimin e qasjeve pedagogjike, të mjediseve të të mësuarit, zhvillimin e shkrim-leximit digjital midis mësuesve dhe nxënësve dhe qeverisjen me pjesëmarrje të sistemeve arsimore.

Edukimi për qytetarinë digjitale ofron një mundësi për ta bërë këtë duke ofruar një kornizë pedagogjike që përshtatet në mënyrë holistike në të gjithë kurrikulën. Ai integron kompetencat e përcaktuara në Kuadrin e Referencës së Kompetencave për Kulturë Demokratike të Këshillit të Evropës dhe mbulon dhjetë fushat e aktiviteteve të prekura nga teknologjitë digjitale. Këto fusha janë të grupuara gjerësisht në tre grupe: **Të qenit online**, që përfshin fusha që lidhen me kompetencat e nevojshme për të hyrë në shoqërinë digjitale, për t'u shprehur lirisht dhe për të përdorur mjetet digjitale në mënyrë krijuese dhe kritike; **Mirëqenia në internet**, e cila përfshin fusha që lidhen me kompetencat e nevojshme për t'u angazhuar pozitivisht në shoqërinë digjitale dhe për të zhvilluar një marrëdhënie të shëndetshme me teknologjinë; **Të drejtat në internet**, që

përfshijnë fusha që lidhen me kompetencat që lidhen me të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në shoqëri komplekse, të larmishme në një kontekst digjital, ku mbrohet privatësia dhe fuqizohet pjesëmarrja aktive.

Edukimi për qytetari demokratike në dokumentet strategjike të arsimit në Shqipëri

Shoqëria e ndryshuar shqiptare dhe kërkesat e bashkëjetesës demokratike shtrojnë përpara arsimit:

- nevojën për të unifikuar vizionet dhe perspektivat afatshkurtra dhe afatgjata të veprimit qytetar demokratik;
- domosdoshmërinë për t'u transmetuar të rinjve tanë njohuri, vlera e shprehi të reja, por edhe kompetencën qytetare për t'i përdorur ato dhe për t'u integruar e përfshirë cilësisht në veprimin e përgjegjshëm qytetar,
- nevojën për të përgatitur mësues qytetarë dhe të kualifikuar, që të jenë të aftë:
 - të njohin e të përhapin konceptimet dhe praktikat e reja bashkëkohore në fushën e qytetarisë;
 - të mbështesin dhe sigurojnë bashkëpunimin ndërmjet shkollës, familjes, komunitetit dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për ndërtimin e shoqërisë së re demokratike;
 - të kuptojnë tendencat sociale, ekonomike, kulturore etj., të shoqërisë shqiptare e më gjerë e të përballojnë sfidat e reja të kohës, zhvillimit, transformimit e progresit etj.

Cilat janë bazat politike dhe legjislative mbi të cilat ngrihet politika e edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri?

1. Kushtetuta e Shqipërisë. Në Shqipëri, detyrimi i sistemit arsimor për të ushqyer arsimin me vlerat dhe parimet e EQD/EDNJ buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si bazë për respektimin dhe mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive, trashëgimisë kombëtare, bashkëjetesës fetare dhe bashkëjetesës me pakicat, të cilat janë baza e shtetit.

2. Ligji për Arsimin Parauniversitar. Në këtë drejtim, ndryshimet e bëra në Ligjin për Arsimin Parauniversitar, i cili është ligji kryesor që rregullon veprimtarinë e sistemit arsimor parauniversitar, përmban 8 kompetencat kyçe të Bashkimit Evropian në të cilat përfshihet kompetenca e qytetarisë, vetëdijes dhe shprehjes kulturore.

3. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, një dokument që është hartuar bazuar në vlerat e Këshillit të Evropës, me një vizion për arsimin, synon të arrijë “Një sistem arsimor cilësor të bazuar në parimet e përfshirjes dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës, i cili u mundëson të gjithë individëve të arrijnë potencialin e tyre të plotë duke kontribuar kështu në mirëqenien e tyre personale, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integritetit të vendit.

4. Karta e Këshillit të Evropës për Qytetarinë Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, e cila kërkon nga shtetet anëtare:

- a) Së pari, përfshirja e arsimit për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut në kurrikulat për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm si dhe në arsimin dhe aftësimin e përgjithshëm dhe profesional.
- b) Së dyti, të vazhdojë të mbështesë, rishikojë dhe përditësojë edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut në këto kurrikula me qëllim që të sigurohet rëndësia e tyre dhe të inkurajohet qëndrueshmëria e kësaj fushe.

5. Kuadri i referencës së kompetencave për kulturën demokratike i Këshillit të Evropës: 3 vëllime që përcaktojnë jo vetëm grupin prej 20 kompetencash dhe treguesit e tyre përkatës, por edhe një vizion dhe rekomandime të qarta për t'i bërë ato pjesë të politikës dhe praktikës së mësimdhënies dhe të nxënies.

2 PËRMBAJTJA E KURRIKULËS SË LËNDËS SË QYTETARISË

Përmbajtja e lëndës së Qytetarisë trajton jo vetëm realitetin shqiptar, si të ndryshuar dhe ende në ndryshim, problemet dhe sfidat përkatëse, por edhe realitetin evropian dhe global. Si e tillë, kurrikula e kësaj lënde është përbërur vazhdimisht me sfidën e ndryshimit të faktorëve lokalë, ekonomikë, socialë, kulturorë, por edhe nga këndvështrimi i angazhimit të vendit për integrim dhe anëtarësimin e tij të ardhshëm në BE.

Një listë e gjatë çështjesh që janë bërë prioritet për sistemin arsimor përfshijnë edukimin për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut, edukimin kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, edukimin mbi fenë dhe çështjet e lidhura me to, edukimin e medias dhe

informacionit, edukimin ligjor të publikut, edukimin gjinor, edukimin kundër diskriminimit, edukimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore, edukimin kundër abuzimit seksual dhe edukimin për përfshirje.

Përmbajtja e lëndës së qytetarisë ka në themel Kompetencat themelore të përcaktuara në Kuadrin e Referencës së Kompetencave për Kulturë demokratike.

2.1 KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE

2.1.1 VLERAT

1. Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut

Nxënësi:

- Argumenton që të drejtat e njeriut duhet të mbrohen dhe të respektohen gjithmonë.
- Argumenton që të drejtat e veçanta të fëmijëve duhet të respektohen dhe të mbrohen nga shoqëria.
- Mbron pikëpamjet se askush nuk duhet të jetë objekt i torturës, i trajtimeve poshtëruese ose i ndëshkimit.
- Argumenton se të gjitha institucionet publike duhet të respektojnë, të mbrojnë dhe të zbatojnë të drejtat e njeriut.
- Mbron pikëpamjen që kur njerëzit janë të burgosur, megjithëse ata janë objekt i kufizimeve, nuk do të thotë që ata meritojnë më pak respekt dhe dinjitet se të tjerët.
- Shpreh pikëpamjen se të gjitha ligjet duhet të jenë në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

2. Vlerësimi i larmisë kulturore

Nxënësi:

- Mbështet pikëpamjen se ne duhet të jemi tolerantë për besimet e ndryshme që mbahen nga të tjerët në shoqëri.

- Mbështet pikëpamjen se secili duhet të përpiqet për mirëkuptimin e ndërsjellë dhe të kuptimshëm të dialogut ndërmjet njerëzve dhe grupeve që perceptohen “të ndryshëm” nga njëri-tjetri.
- Shpreh pikëpamjen se larmia kulturore në shoqëri duhet të vlerësohet dhe të çmohet pozitivisht.
- Argumenton se dialogu ndërkulturor duhet të na ndihmojë të njohim identitetet tona të ndryshme dhe përkatësitë kulturore.
- Argumenton që dialogu ndërkulturor duhet të zhvillojë respektin dhe kulturën e “të jetuarit së bashku”.

3. Vlerësimi i demokracisë, i drejtësisë, i ndershmërisë, i barazisë dhe i shtetit të së drejtës

Nxënësi:

- Argumenton që shkollat duhet të mësojnë nxënësit për demokracinë dhe si të veprojnë si qytetarë demokratë.
- Shpreh pikëpamjen që të gjithë qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të paanshme nga ligji.
- Argumenton se ligjet duhet të zbatohen gjithmonë në mënyrë të ndershme.
- Argumenton se zgjedhjet demokratike duhet të zhvillohen të lira dhe të ndershme, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me legjislacionin vendas.
- Shpreh pikëpamjen se kurdoherë, që një punonjës publik ushtron pushtet, ai duhet të mos e keqpërdorë pushtetin dhe të kapërcejë kufijtë e autoritetit ligjor
- Mbështet pikëpamjen se gjykata duhet t’u garantohen të gjithëve në mënyrë që njerëzve të mos iu mohohen mundësitë për të çuar një çështje në gjykatë për shkak të pamundësisë financiare e të karakterit të ndërlikuar.
- Mbështet pikëpamjen se ata të cilëve u është besuar pushteti legjislativ, duhet të jenë objekt i mbikëqyrjes ligjore dhe i mbikëqyrjes së duhur mbarë institucionale.
- Shpreh pikëpamjet se informimi për politikat publike dhe zbatimimi i tyre duhet t’i bëhen të njohura publikut.
- Argumenton nevojën e masave të efektshme kundër veprimeve të autoriteteve publike të cilat shkelin të drejtat civile.

2.1.2 QËNDRIMET

1. Të qenit i hapur ndaj kulturave të tjera

Nxënësi:

- Tregon interes për të mësuar për besimet, vlerat, traditat e njerëzve të tjerë dhe të botëkuptimeve.
- Shpreh interes për të udhëtuar në vende të tjera.
- Shpreh kureshtjen për besimet dhe interpretimet e të tjerëve, orientimet dhe grupimet kulturore.
- Shpreh vlerësimin e vet lidhu me mundësinë për të pasur përvoja të kulturave të tjera.
- Kërkon dhe mirëpret mundësitë për të takuar njerëz me vlera, zakone dhe sjellje të ndryshme.
- Kërkon kontakte me njerëz të tjerë për të mësuar për kulturën e tyre.

2. Respekti

Nxënësi:

- U jep hapësirë të tjerëve për të shprehur vetveten.
- Shpreh respektin për njerëzit e tjerë si qenie të barabarta njerëzore.
- Trajton të gjithë njerëzit me respekt, pavarësisht nga prejardhja e tyre kulturore.
- Shpreh respekt për njerëzit me status ekonomik e social të ndryshëm nga i veti.
- Shpreh respekt për ndryshimet fetare.
- Shpreh respekt për njerëzit që kanë pikëpamje politike të ndryshme nga të vetat.

3. Mendësia qytetare

Nxënësi:

- Shpreh vullnetin për të bashkëpunuar me të tjerët.

- Bashkëpunon me të tjerët për çështje të interesit të përbashkët.
- Shpreh përkushtimin për të mos qenë vëzhgues pasiv kur shkelet dinjiteti dhe të drejtat e të tjerëve.
- Diskuton për çfarë mund të bëhet për të ndihmuar komunitetin të bëhet një vend më i mirë.
- Ushtron detyrimet dhe përgjegjësitë e qytetarisë aktive në nivel vendor, kombëtar ose global.
- Ndërmerr veprime për të qenë i informuar për çështjet qytetare.

4. Përgjegjësia

Nxënësi:

- Tregon që pranon përgjegjësinë për veprimet e veta.
- Kërkon ndjesë kur lëndon ndjenjat e dikujt.
- Dorëzon punën e kërkuar në kohë.
- Dëshmon përgjegjësinë për gabimet e veta.
- Përmbush angazhimet e veta ndaj të tjerëve gjithmonë.

5. Efektshmëria e veprimeve

Nxënësi:

- Shpreh besimin në aftësinë e vet për të kuptuar çështjet.
- Shpreh besimin që mund të kryejë veprimtaritë që ka planifikuar.
- Shpreh besim në aftësitë e veta për të eksploruar pengesat gjatë arritjes së qëllimit.
- Shpreh besimin se mund të ndryshojë nëse e dëshiron një gjë të tillë.
- Tregon siguri në aftësitë e veta për të përballuar me sfidat e jetës.

- Tregon besim se e di si mund të menaxhojë situatat e paparashikuara duke u bazuar në burimet e veta.

6. Toleranca ndaj paqartësisë

Nxënësi:

- Bashkëvepron mirë me të tjerët që kanë larmi pikëpamjesh të ndryshme.
- Tregon që është në gjendje të ndërpresë përkohësisht gjykimet për të tjerët.
- Ndihet rehat në situata të panjohura.
- Trajton pozitivisht dhe në mënyrë konstruktive situatat e pasigurta.
- Punon mirë në rrethana të paparashikuara.
- Shpreh dëshirën për t'u sfiduar në idetë dhe dëshirat e veta.
- Kënaqet me sfidat e trajtimit të problemeve të paqarta
- Ndihet mirë gjatë trajtimit të situatave të ndërlikuara.

2.1.3 AFTËSITË

7. Aftësia e të mësuarit të pavarur

Nxënësi:

- Tregon shkathhtësinë për të identifikuar burimet për të mësuarit (p.sh. njerëzit, librat, interneti);
- Kërkon, kur është e nevojshme, qartësimin e informacionit të ri të marrë nga njerëz të tjerë;
- Mund të mësojë për tema të reja me mbikëqyrje minimale;
- Mund të vlerësojë cilësinë e punës së tij;
- Mund të përzgjedhë burimet më të besueshme të informacionit ose të këshillave nga ato që janë të pranishme;

- Tregon aftësinë për të mbikëqyrur, për të përcaktuar dhe për të plotësuar detyra pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë.

8. Aftësia e menduarit analitik dhe kritik

Nxënësi:

- Mund të identifikojë ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet informacionit të ri dhe atij të njohur;
- Përdor evidenca për të mbështetur opinionin e vet;
- Mund të vlerësojë rreziqet që lidhen me alternativa të ndryshme;
- Dëshmon që ai mendon për përdorimin e drejtë të informacionit;
- Mund të identifikojë hendeqet, mungesën e lidhjes ose divergjencat në materialet e analizuara;
- Mund të përdorë kritere të qarta dhe të veçanta, parime ose vlera për të bërë gjykime.

9. Aftësia për të dëgjuar dhe për të vëzhguar

Nxënësi:

- Dëgjon me kujdes opinionet e ndryshme.
- Dëgjon me vëmendje të tjerët.
- Vëzhgon gjestet e folësve dhe gjuhën e përgjithshme të trupit për të kuptuar më mirë fjalët e tyre.
- Mund të dëgjojë në mënyrë të efektshme për të deshifruar kuptimin ose qëllimet e një personi tjetër.
- I kushton vëmendje asaj çfarë të tjerët nënkuptojnë por nuk e shprehin
- I kushton vëmendje mënyrës si njerëzit nga kultura të tjera reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj të njëjtës situatë.

10. Empatia

Nxënësi:

- Mund të dallojë kur një shok ka nevojë për ndihmë.

- Shpreh simpatinë për gjërat e këqija që ka parë t'u ndodhin të tjerëve.
- Përpiqet të kuptojë më mirë miqtë, duke përfytyruar gjërat nga këndvështrimi i tyre.
- Merr parasysh ndjenjat e njerëzve të tjerë kur merr vendime.
- Shpreh pikëpamjen se kur mendon për të tjerët në vende të tjera, ai ndan me ta gëzimet dhe hidhërimet e tyre.
- Identifikon me kujdes ndjenjat e të tjerëve, edhe në rastet ku ata nuk duan t'i tregojnë ato.

11. Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria

Nxënësi:

- Ndryshon opinionin e vet nëse dëshmohet përmes argumenteve të arsyeshme se kjo është e nevojshme dhe kërkohet të bëhet.
- Mund të ndryshojë vendimet që ka bërë nëse kjo kërkohet nga pasojat e këtyre vendimeve.
- Përshtatet ndaj situatave të reja, duke përdorur aftësi të reja.
- Përshtatet ndaj situatave të reja duke përdorur njohuritë në mënyra të ndryshme.
- Përshtat konventat socio-kulturore të grupeve të tjera kulturore kur bashkëvepron me anëtarët e këtyre grupeve.
- Mund të ndryshojë sjelljen e vet për ta përshtatur me kulturat e tjera.

12. Aftësitë gjuhësore, komunikuese dhe shumëgjuhëshe

Nxënësi:

- Mund të shpreh mendimet e veta për një problem.
- U kërkon folësve të përsërisin çfarë kanë thënë, nëse nuk është e qartë për të.
- Bën pyetje që dëshmojnë të kuptuarit e pozicionit të njerëzve të tjerë.
- Mund të përshtatë mënyra të ndryshme të shprehjes së mirësjelljes në një gjuhë tjetër.

- Mund të ndërmjetësojë me anë të gjuhës, përmes përkthimit, interpretimit ose shpjegimit, në shkëmbime ndërkulturore.
- Mund të shmangë me sukses keqkuptimet ndërkulturore.

13. Aftësia për të bashkëpunuar

Nxënësi:

- Ndërton marrëdhënie pozitive me të tjerët në grup.
- Ndan punën me të tjerët kur punon si anëtar i një grupi.
- Punon për të ndërtuar konsensus për të arritur synimet e grupit.
- Si anëtar i një grupi, mban të tjerët të informuar për informacione të dobishme që lidhen me interesat e tyre.
- Prodhon entuziazëm ndërmjet anëtarëve të grupit për përbashkjen e synimeve të përbashkëta.
- Kur punon me të tjerët, i mbështet ata pavarësisht nga ndryshimet në pikëpamje.

14. Aftësia për zgjidhjen e konflikteve

Nxënësi:

- Mund të komunikojë me respekt me palët në konflikt.
- Mund të identifikojë rrugë të ndryshme për zgjidhjen e konflikteve.
- Mund të ndihmojë të tjerët për të zgjidhur konfliktet përmes rritjes së shkallës së kuptimit të alternativave të pranishme.
- Mund të nxisë palët e përfshira në konflikt për të dëgjuar në mënyrë aktive njëri-tjetrin dhe për të ndarë çështjet në interes të përbashkët.
- Nis rregullisht komunikimin për të ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve ndër personale.
- Mund të trajtojë me efektivitet stresin emocional, ankthin dhe pasigurinë e njerëzve të tjerë në situata konfliktuale.

2.1.4 NJOHURITË DHE TË KUPTUARIT KRITIK

1. Njohja dhe të kuptuarit kritik të vetes

Nxënësi:

- Mund të përshkruajë emocionet e tij.
- Mund të përshkruajë mënyrat në të cilën mendimet dhe emocionet e veta ndikojnë sjelljen e tij.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për vlerat dhe besimet e tij.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për veten nga këndvështrime të ndryshme.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për paragjykimet dhe stereotipat e veta dhe për shkaqet e tyre.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për emocionet dhe ndjenjat në situata të ndryshme e të larmishme.

2. Njohja dhe të kuptuarit kritik të gjuhës dhe komunikimit

Nxënësi:

- Mund të shpjegojë se si toni i zërit, kontakti pamor dhe gjuha e shenjave mund të ndihmojnë komunikimin.
- Mund të përshkruajë ndikimin social dhe pasojat e stileve të ndryshme të komunikimit tek të tjerët.
- Mund të shpjegojë se si marrëdhëniet shoqërore disa herë janë të koduara në format gjuhësore që përdoren në biseda (p.sh. në përshëndetje, në format për t'u drejtuar dikujt etj.).
- Mund të shpjegojë përse njerëzit e kulturave të tjera mund të ndjekin modele të ndryshme komunikimi, verbale dhe jo verbale, të cilat janë të rëndësishme në këndvështrimin e tyre.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për modelet e ndryshme komunikimit që përdoren të paktën në një grup shoqëror ose kulturor.

3. Njohja dhe të kuptuarit kritik të botës (duke përfshirë politikën, ligjin, të drejtat e njeriut, kulturën, kulturat, fetë, historinë, median, ekonominë, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm)

Nxënësi:

- Mund të shpjegojë kuptimin e koncepteve politike bazë, duke përfshirë demokracinë, lirinë, qytetarinë, të drejtat dhe përgjegjësitë.
- Mund të shpjegojë përse secili ka përgjegjësi të respektojë të drejtat e njeriut të tjerëve.
- Mund të përshkruajë praktikat kulturore bazë (p.sh. zakonet e të ushqyerit, praktikat e përshëndetjeve, mënyrën si u drejtohem i njerëzve, mirësjelljen) në një kulturë tjetër.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike se si botëkuptimi i vet është një ndër botëkuptimet e shumta në botë.
- Mund të vlerësojë ndikimin e shoqërisë në natyrën e botës, për shembull, nga pikëpamja e rritjes së popullsisë, e zhvillimit të popullsisë, e konsumit të burimeve.
- Mund të reflektojë për rreziqet që lidhen me dëmtimin e mjedisit.
- Mund të shpjegojë natyrën universale, të patjetërsueshme dhe të pandashme të të drejtave të njeriut.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për marrëdhëniet ndërmjet të drejtave të njeriut, demokracisë, paqes dhe sigurisë në një botë të globalizuar.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për shkaqet rrënjësore të shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe rolin e stereotipave dhe paragjytimeve në proceset që çojnë në abuzimin me të drejtat e njeriut.
- Mund të shpjegojë rreziqet e përgjithësimin nga sjelljet individuale tek e tërë kultura.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për simbolet fetare, rritualet fetare dhe përdorimin fetar të gjuhës.
- Mund të përshkruajë pasojat e propagandës në botën e sotme.
- Mund të shpjegojë se si njerëzit mund të ruajnë dhe të mbrojnë veten nga propaganda.

- Mund të përshkruajë mënyrat e ndryshme në të cilat qytetarët mund të ndikojnë politikën.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike për thelbin ndryshues të kuadrit të të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e vazhdueshëm të të drejtave të njeriut në rajone të ndryshme të botës.
- Mund të shpjegojë përse nuk ka grupe kulturore që kanë karakteristika të brendshme të pandryshueshme.
- Mund të shpjegojë përse të gjitha grupet fetare janë në zhvillim dhe ndryshim të pandërprerë.
- Mund të reflektojë në mënyrë kritike përse, shpesh herë, historitë paraqiten dhe mësohen nga pikëpamja etnocentrike.
- Mund të shpjegojë ekonominë kombëtare dhe se si proceset ekonomike dhe financiare ndikojnë në funksionimin e shoqërisë.

2.2 DIMENSIONET E QYTETARISË DEMOKRATIKE

Përmbajtja e konceptit të qytetarisë demokratike është shumë e larmishme dhe shumë dimensionale. Ajo përbëhet nga:

- Dimensioi politik, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.
- Dimensioi ligjor, qëndrimi dhe përgjegjësia qytetare ndaj rregullave dhe ligjit, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve. Etj.
- Dimensioi etik, vetëdija për shtyllat kryesore të edukimit të fëmijëve për integritet moral e luftë kundër korrupsionit.
- Dimensioi kulturor, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.
- Dimensioi shoqëror, ekonomik e financiar, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.

- Dimensiononi i karrierës, si pjesë e edukimit për vendimmarrje të mirinformuar dhe për kompetencë
- Dimensiononi evropian, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.
- Dimensiononi global, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe të solidaritetit global.
- Dimensiononi i qytetarisë digjitale, të qenit online, mirëqenia online, media dhe informimi etj.

Programi i lëndës i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave të qytetarisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Qëllimet e përgjithshme të programit të lëndës së qytetarisë

Edukimi për qytetari demokratike synon:

- të përgatisë të rinjtë për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe përkushtimin për të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i lëndës së qytetarisë synon:

- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- T'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Programi i lëndës Qytetaria për klasën e dhjetë ndërtohet mbi dimensionin ligjor të përmbajtjes së kësaj lënde.

Edukimi ligjor në kuadrin e edukimit për qytetari demokratike synon të pajisë të rinjtë me njohuri rreth ligjit, sistemit ligjor dhe parimeve themelore dhe vlerave mbi të cilat ngrihet një demokraci kushtetuese. Nëpërmjet kësaj lënde të rinjtë njihen me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, zhvillojnë njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet që i aftësojnë ata të veprojnë në përputhje me ligjin por dhe të jenë qytetarë pjesëmarrës në jetën dhe bërjen e demokracisë. Kjo lëndë synon t'u japë nxënësve mundësinë të njihen me konceptin e ligjit në shoqërinë demokratike si dhe me koncepte të tilla si drejtësia, liria, përgjegjësia, barazia e trajtimit, kushtetuta etj.

E veçanta e kësaj lënde qëndron në faktin që vetë nxënësit duhet të shndërrohen në partnerë në procesin e të nxënësve. Përmes kësaj lënde aftësitë për të menduar në mënyrë kritike fitohen dhe ushtrohen në proces praktik, ndërkohë që ata debatojnë rreth çështjeve të ndryshme, diskutojnë politikën publike, mësojnë të zgjidhin mosmarrëveshjet apo marrin pjesë në dramatizime, gjyqe imitimi etj.

Për realizimin e synimeve të lëndës mësuesit punojnë krahas krahas me avokatë, gjykatës, punonjës socialë, policë, ligjvënës dhe profesionalistë të fushave të tjera me qëllim që të sjellin komunitetin, ku jetojnë, në klasë. Për këtë arsye lënda edukimi ligjor i ndihmon nxënësit të mësojnë dhe përvetësojnë aftësitë dhe shprehjet jetësore të domosdoshme për të arritur suksesin në jetë, siç janë p.sh.. aftësia për të zgjidhur problemet, aftësia socializuese, autonomia etj. Përdorimi i strategjive ndërvepruese të mësimdhënies i ndihmon nxënësit të identifikojnë dhe klasifikojnë zgjidhjet e

ndryshme të problemit, të vlerësojnë alternativat dhe pasojat e tyre, të zgjerojnë perspektivat dhe të mendojnë në mënyrë kritike, të përgatiten me ndjenjën e respektimit të tyre në praktikë si dhe të parandalojnë shkeljet e tyre.

Në kuadrin e këtij dimension, ky program synon:

- Të pajisë nxënësit me njohuritë e domosdoshme praktike për ligjin dhe për sistemin ligjor dhe me aftësitë për t'i përdorur ato në jetën e përditshme;
- Të rrisë nivelin e përvetësimit dhe kuptimit të parimeve dhe vlerave që qëndrojnë në themel të kushtetutës, ligjeve dhe sistemit ligjor;
- Të rritë nivelin e ndërgjegjësimit dhe të njohurive për çështjet dhe kundërshtitë e sotme lidhur me ligjin dhe sistemin ligjor;
- Të nxisë pjesëmarrjen aktive qytetare në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut;
- Të nxisë ndjenjën e tolerancës, të paanshmërisë dhe të drejtësisë;
- Të zhvillojë vullnetin dhe aftësinë për të zgjidhur mosmarrëveshjet përmes rrugës (mekanizmave) zyrtarë dhe, kur është e nevojshme, përmes rrugës (mekanizmave) jo zyrtare;
- Të zhvillojë më tej aftësitë bazë si, të menduarit kritik dhe arsyetimi, komunikimi, vëzhgimi, zgjidhja e problemit etj.;
- Të zhvillojë njohuritë dhe të kuptuarit për rolin që ligji, sistemi ligjor, mekanizmat e shtrëngimit ligjor, gjyqtarët, avokatët etj., luajnë në shoqëri etj.

3 REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE NË KLASËN E DHJETË

Në programin e qytetarisë janë paraqitur rezultatet e pritshme të të nxënësit, të cilat shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj ose grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e

përdoruesve të programit (më kryesorët janë autorët e teksteve dhe mësuesit). Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është relativisht rekomanduese.

<p style="text-align: center;">TEMATIKA: LIGJI</p> <p style="text-align: center;">5 ORË</p>		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime e sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>Ligji: Rregullatori themelor i shoqërisë</p> <p>Ligji është shumë më tepër sesa thjesht një sërë rregullash; ai është themeli mbi të cilin ndërtohet shoqëria jonë, duke i dhënë formë dhe rend jetës së përditshme. Qëllimi kryesor i ligjit është të sigurojë drejtësi, rend dhe siguri për të gjithë. Natyra e tij është ajo e një mjeti rregullator që shërben për të menaxhuar marrëdhëniet mes individëve, institucioneve dhe shtetit. Pa ligj, do të mbizotëronte kaosi, ndaj rëndësia e tij në shoqëri është thelbësore për të garantuar funksionimin e saj normal. Ligji zbatohet në mënyrë të vazhdueshme,</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë dhe shpjegojë ç ‘është ligji, duke theksuar rolin e tij si një mjet thelbësor për vendosjen e rendit dhe sigurisë në shoqëri. • Të identifikojë dhe të përshkruajë qëllimet kryesore të ligjit, si garantimi i drejtësisë, rregullimi i sjelljeve, mbrojtja e të drejtave dhe parandalimi i konflikteve. • Të analizojë natyrën dhe funksionet e ndryshme të ligjit, duke kuptuar se si ai ndikon në marrëdhëniet shoqërore, ekonomike dhe politike. 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojë rëndësinë e ligjit në ruajtjen e stabilitetit dhe zhvillimit të një shoqërie demokratike. • Të demonstrojë sjellje ligj zbatuese në jetën e përditshme

<p>duke u përshtatur me kontekstin kohor dhe hapësinor, duke siguruar që normat të jenë të vlefshme dhe efektive kudo e në çdo kohë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojë rëndësinë e ligjit në ruajtjen e stabilitetit dhe zhvillimit të një shoqërie demokratike. • Të diskutojë zbatimin e ligjit në kontekste të ndryshme kohore dhe hapësinore, duke kuptuar fleksibilitetin dhe adaptimin e tij ndaj nevojave 	
<p>Ligji dhe vlerat: një lidhje thelbësore</p> <p>Ligji nuk ekziston në një vakum; ai është i lidhur ngushtë me vlerat që mbështet dhe promovon. Vlerat morale të ligjit pasqyrojnë parimet e drejtësisë, barazisë dhe respektit për dinjitetin njerëzor. Vlerat politike sigurojnë pjesëmarrjen qytetare dhe funksionimin demokratik të shtetit.</p> <p>Nga ana tjetër, vlerat ekonomike synojnë të rregullojnë tregjet dhe të garantojnë një shpërndarje të drejtë të burimeve, ndërsa vlerat sociale fokusohen te mirëqenia dhe kohezioni i shoqërisë.</p> <p>Është thelbësore që këto vlera të merren parasysh gjatë hartimit dhe zbatimit të ligjeve,</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë dhe të shpjegojë lidhjen midis ligjit dhe vlerave themelore të një shoqërie, siç janë vlerat morale, politike, ekonomike dhe sociale. • Të dallojë dhe të analizojë se si vlerat morale (p.sh., drejtësia, barazia), politike (p.sh., demokracia, liria), ekonomike (p.sh., zhvillimi i qëndrueshëm, shpërndarja e pasurisë) dhe sociale (p.sh., mirëqenia, kohezioni) pasqyrohen në ligje. • Të analizojë ligjin në këndvështrimin e vlerave mbi të cilat ngrihen dhe të justifikimit të tij në raport me vlerat që duhet të mbrojnë • Të argumentojë rëndësinë e marrjes parasysh të këtyre vlerave gjatë procesit të hartimit dhe 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <p>Të mbajë qëndrimin kureshtar dhe të jetë i gatshëm për të thelluar njohuritë përtej sipërfaqes</p> <p>Të jetë ndjeshëm ndaj çështjeve sociale dhe etike që ndikojnë në shoqëri</p> <p>Të shprehë ndjenjën e përgjegjësisë qytetare dhe të empatisë ndaj të tjerëve.</p> <p>Të jetë i hapur ndaj njohurive nga fusha të ndryshme.</p>

<p>pasi vetëm kështu ligji mund të jetë i drejtë, efikas dhe i pranueshëm për qytetarët.</p> <p>Po kështu, nxënësi mëson të shohë lidhjen midis ligjit (fushës ligjore) dhe fushave të tjera si politika, ekonomia dhe sociologjia. Për shembull, duhet të jetë në gjendje të shpjegojë se një ligj për mbrojtjen e konsumatorit nuk është vetëm një rregull ligjor, por ka një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi dhe mirëqenien e qytetarëve.</p>	<p>zbatimit të ligjeve për të siguruar efektivitetin dhe legjitimitetin e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë dhe të shpjegojë lidhjen ndërmjet një ligji dhe vlerë me fushat e tjera të jetë, si ekonomia, politika, si dhe ndikimin e drejtpërdrejtë që atë kanë në mirëqenien e qytetarëve 	<p>Të shprehë qëndrim objektiv dhe të bazuar në fakte, duke shmangur opinionet e pabazuara.</p>
<p>Llojet e ligjeve</p> <p>Shoqëria moderne karakterizohet nga një larmi e gjerë marrëdhëniesh shoqërore dhe juridike. Ligjet shërbejnë si rregullatorë të këtyre marrëdhëniesh, duke siguruar që çdo fushë e jetës të ketë normat e veta. Ka një sërë llojeve të ligjeve, siç janë ato civile, penale, administrative, kushtetuese, etj., secili prej tyre i krijuar për të trajtuar sfida dhe nevoja specifike në fushat përkatëse. Kjo larmi</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë larminë e marrëdhëniesh shoqërore dhe juridike dhe si ligjet shërbejnë si rregullatorë specifikë për secilën fushë: <ul style="list-style-type: none"> ○ të identifikojë se një çështje, siç është një mosmarrëveshje për një pronë, ka rrënjë në marrëdhënie shoqërore por zgjidhet përmes një marrëdhënieje juridike. ○ të tregojë lidhjen ndërmjet pjesëve të ndryshme të sistemit 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jetë analitik dhe kërkues për të kuptuar bashkëveprimin e pjesëve të një sistemi dhe të rregullimit të tyre ligjor . • Të jetë i prirur për të kërkuar qartësinë e nevojshme e për të mos u mbingarkuar me detaje

<p>siguron që të gjitha aspektet e jetës shoqërore të jenë të mbuluara nga kuadri ligjor</p> <p>Pr.sh. nxënësi aftësohet që në vend që t'i shohë ligjet si një listë rregullash të ndara, duhet të kërkojë lidhjen e tyre me fusha të ndryshme të jetës. Pra, të jesh në gjendje të identifikosh se një çështje, siç është një mosmarrëveshje për një pronë, ka rrënjë në marrëdhënie shoqërore (marrëdhënia mes fqinjëve), por zgjidhet përmes një marrëdhënieje juridike (ligji civil). Me anë të këtij mësim, nxënësi aftësohet të dallojë ligjet që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë (ligji administrativ).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të klasifikojë dhe të përshkruajë llojet kryesore të ligjeve (p.sh., Kushtetues, Civil, Penal, Administrativ), duke dhënë shembuj për secilin dhe duke shpjeguar fushën e tyre të veprimit. • Të klasifikojë informacionin ligjor në kategori të qarta • Të ilustrojë me shembuj nga jeta funksionin e ligjeve të veçanta 	<ul style="list-style-type: none"> • Të jetë i prirur drejt mundësive praktike të zbatimit të ligjit
<p>Ligji dhe Unë: Përgjegjësia Individuale</p> <p>Rëndësia e ligjit në shoqëri nuk mund të kuptohet plotësisht pa përfshirjen e rolit individual. Zbatimi i ligjit nuk është vetëm një detyrë e shtetit, por edhe një përgjegjësi e çdo qytetari. Pasojat e zbatimit ose moszbatimit të ligjit janë të thella, si për individin ashtu edhe</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të ligjit nga ana e çdo individi për funksionimin e shoqërisë dhe ruajtjen e të drejtave. • Të analizojë pasojat e zbatimit dhe moszbatimit të ligjit, si për individin (p.sh., siguria 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jetë model i zbatimi të rregullave dhe të ligjeve në jetën e përditshme

<p>për shoqërinë në tërësi. Një individ që respekton ligjin kontribuon në një shoqëri më të sigurt dhe më të drejtë, ndërsa moszbatimi i tij sjell sanksione dhe dëmton kohezionin social. Cilësia e zbatimit të ligjit varet nga shumë faktorë, duke përfshirë efikasitetin e institucioneve, ndërgjegjësimin e qytetarëve, nivelin e korrupsionit dhe besimin e publikut tek sistemi ligjor. Kështu, ligji dhe roli ynë si qytetarë janë të ndërthurur ngushtë, duke formuar bazën e një shoqërie funksionale dhe harmonike.</p>	<p>personale, liria, sanksionet) ashtu edhe për shoqërinë (p.sh., rendi publik, zhvillimi, korrupsioni).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë dhe të diskutojë faktorët që ndikojnë në cilësinë e zbatimit të ligjit (p.sh., integriteti i institucioneve, ndërgjegjësimi qytetar, sistemi i drejtësisë). • Të zhvillojë një ndjenjë përgjegjësie personale dhe aktive ndaj respektimit të ligjit dhe promovimit të një kulture ligjore në mjedisin tuaj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të evidentojë raste të moszbatimit të ligjit dhe të tregojë pasojat negative të tij • Të evidentojë raste të zbatimit të ligjit, me qëllim argumentin e rëndësisë së respektimit dhe të zbatimit të ligjit në shoqëri
--	---	--

TEMA: KUSHTETUTA

3 ORË

Njohuri	Aftësi	Qëndrime e sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>Kushtetuta: Themel i shtetit dhe mbrojtëse e të drejtave</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje:</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të</p>

<p>Kushtetuta është ligji suprem i çdo shteti, dokumenti themeltar që qëndron mbi të gjitha ligjet e tjera. Ajo shërben si burimi kryesor i legjislacionit, duke siguruar që çdo ligj i miratuar në vend të jetë në përputhje me parimet dhe dispozitat e saj. Për më tepër, Kushtetuta përcakton formën e shtetit, duke vendosur nëse është një republikë, monarki, apo ndonjë formë tjetër qeverisjeje, si dhe strukturën e përgjithshme politike të vendit. Një nga funksionet më jetike të saj është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke garantuar që çdo qytetar të gëzojë të drejta të patjetërsueshme si liria e shprehjes, e drejta për jetë, apo e drejta për një proces të rregullt ligjor.</p> <p>Kushtetuta gjithashtu detajon strukturën dhe kompetencat e organeve kryesore të shtetit, siç janë parlamenti (Kuvendi), qeveria, presidenti, dhe gjykatat. Ajo vendos qartësisht ndarjen mes tyre, duke zbatuar parimin e ndarjes dhe</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë dhe shpjegojë rolin e Kushtetutës si ligji më i lartë i shtetit, duke theksuar sundimin e saj mbi të gjitha aktet e tjera ligjore. • Të shpjegojë pse Kushtetuta duhet të jetë ligji më i lartë dhe pse ndarja e pushteteve është e nevojshme për të parandaluar abuzimet. • Të argumentojë pse Kushtetuta shërben si burim primar i legjislacionit dhe si të gjitha ligjet e tjera duhet të jenë në përputhje me të. • Të analizojë lidhjen ndërmjet Kushtetutës dhe formës e funksionit të shtetit, duke kuptuar si ajo përcakton natyrën e qeverisjes dhe sistemin politik. • Të tregojë rëndësinë e Kushtetutës në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke kuptuar se si ajo i garanton ato për çdo individ. • Të identifikojë dhe të përshkruajnë strukturën e organeve të shtetit (p.sh., Kuvendi, Presidenti, Qeveria, Gjykatat) dhe kompetencat kryesore të tyre, siç përcaktohen në Kushtetutë. 	<p>demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojnë rëndësinë e Kushtetutës në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke kuptuar se si ajo i garanton ato për çdo individ. • Të demonstrojnë dëshirën për të kuptuar parimet themelore dhe jo thjesht rregullat. • Të demonstrojnë një ndjenjë të fortë të përgjegjësisë qytetare, e cila të shtyn të njohësh të drejtat dhe detyrimet e tua si anëtar i një shoqërie demokratike • Të jetë i prirur për t'u ndjerë i detyruar për të dhënë informacion të vërtetë dhe të saktë.
---	--	---

<p>balancimit të pushteteve – ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ky sistem i kontrolleve dhe balancave është thelbësor për të parandaluar përqendrimin e tepërt të pushtetit në një dorë dhe për të siguruar qeverisjen e mirë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve (ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor) dhe rëndësinë e tij për të parandaluar përqendrimin e pushtetit dhe abuzimet. 	
<p>Parimet Kryesore të Kushtetutës Shqiptare: Barazia dhe Liria</p> <p>Në thelb të Kushtetutës së Shqipërisë qëndrojnë disa parime themelore që drejtojnë funksionimin e shtetit dhe shoqërisë. Një nga më të rëndësishmit është parimi i barazisë, i cili nënkupton se të gjithë janë të barabartë para ligjit, pavarësisht racës, gjinisë, fesë, apo çdo dallimi tjetër. Ky parim siguron që askush të mos diskriminohet dhe që të gjithë të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime ligjore.</p> <p>Lidhja midis lirisë dhe barazisë është komplekse dhe thelbësore. Ndërsa liria garanton individëve të drejtën për të vepruar sipas dëshirës së tyre pa ndërhyrje të</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë dhe të interpretojë kuptimin e parimit të barazisë si një shtyllë themelore e Kushtetutës, duke theksuar që të gjithë janë të barabartë para ligjit. • Të diskutojë dhe të analizojë raportin ndërmjet lirisë dhe barazisë, duke kuptuar se si këto dy parime thelbësore plotësojnë dhe kufizojnë njëra-tjetrën në një shoqëri demokratike. • Të dallojë dhe të shpjegojë ndryshimin midis barazisë formale dhe barazisë reale, duke kuptuar se barazia formale (para ligjit) nuk garanton domosdoshmërisht barazinë reale (në mundësi dhe trajtim). 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë se liria dhe barazia kufizojnë njëra tjetrën • Të pranojnë dallimin ndërmjet barazisë formale dhe gjendjes së saj reale dhe mospërputhjen e tyre në kohë dhe hapësirë • Të pranojnë barazinë si një detyrim kushtetues dhe detyrimin e tyre për të mbrojtur e zbatuar parimet e kushtetutës

<p>panevojshme, barazia siguron që këto liri të jenë të arritshme për të gjithë në mënyrë të barabartë. Shpeshherë bëhet dallimi mes barazisë formale dhe barazisë reale. Barazia formale i referohet barazisë para ligjit – pra, të gjithë kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime ligjore në letër. Ndërsa barazia reale shkon më thellë, duke synuar të trajtojë pabarazitë ekzistuese në shoqëri (p.sh., ekonomike, sociale) dhe të sigurojë që të gjithë të kenë mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre, pavarësisht pikënisjes. Kjo kërkon shpeshherë veprime pozitive për të trajtuar pengesat strukturore që mund të ekzistojnë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të japë shembuj nga jeta e përditshme ose nga konteksti shqiptar për të ilustruar konceptet e barazisë formale dhe reale. 	
---	---	--

TEMATIKA: TË DREJTAT E NJERIUT

10 ORË

<p>Njohuri</p>	<p>Aftësi</p>	<p>Qëndrime e sjellje të dëshiruara dhe të pritshme</p>
-----------------------	----------------------	--

<p>Të drejtat e njeriut</p> <p>Kuptimi dhe rëndësia e të drejtave të njeriut është themeli i këtij kapitulli. Do të shpjegojmë çfarë janë të drejtat e njeriut, duke theksuar se ato janë të drejta të pandashme dhe të patjetërsueshme që i takojnë çdo individ, thjesht sepse është qenie njerëzore. Këto të drejta janë universale, pra vlejnë për të gjithë njerëzit, kudo në botë.</p> <p>Më pas, do të zhytemi në kategoritë e ndryshme të të drejtave të njeriut. Do të mësojmë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat civile dhe politike, të cilat garantojnë liritë individuale dhe pjesëmarrjen në jetën publike, siç janë liria e shprehjes, e votës, dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor. • Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, që sigurojnë mirëqenien dhe zhvillimin njerëzor, përfshirë të drejtën 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë dhe shpjegojë konceptin e të drejtave të njeriut, duke theksuar natyrën e tyre universale, të patjetërsueshme dhe të pandashme. • Të identifikojë dhe dallojë kategoritë kryesore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe të drejtat e mjedisit dhe të zhvillimit. Ju do të jeni në gjendje të jepni shembuj specifikë për secilën kategori. • Të rendisë dhe të shpjegojë të drejtat kryesore të përfshira në Kartën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe pakteve ndërkombëtare përkatëse. • Të analizojë lidhjet dhe ndërvarësinë mes të drejtave të ndryshme të njeriut, duke kuptuar se si shkelja e një të drejte mund të ndikojë negativisht në gëzimin e të tjerave. 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe të gjitha të drejtat themelore.. • Të kritikojnë shkeljet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, në komunitetin tuaj, dhe në shkallë globale. . • Të mbajnë qëndrim mbështetës ndaj mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave jo vetëm tuajat, por edhe të të tjerëve. • Të demonstrojnë ndjeshmëri ndaj situatave të atyre që u shkelen të drejtat. • Të shfaqin qëndrim të gatshëm për të mbrojtur drejtësinë sociale dhe barazinë, duke kuptuar se të drejtat ekonomike, sociale dhe
---	--	--

<p>për punë, arsim, shëndetësi dhe kulturë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat e mjedisit dhe të zhvillimit, që theksojnë rëndësinë e një mjedisi të shëndetshëm dhe zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë. <p>Një pjesë e rëndësishme e studimit tonë do të jetë Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, duke kuptuar cilat janë të drejtat themelore të përfshira në këtë dokument kyç. Do të shohim se si këto të drejta janë të ndërlidhura, pasi lidhjet e të drejtave tregojnë që shkelja e njëres shpeshherë prek edhe të tjerat. Për shembull, mungesa e arsimit mund të kufizojë mundësitë për punë.</p> <p>Nuk do të anashkalojmë as sfidat. Do të diskutojmë situatat kur të drejtat mund të hyjnë në konflikt me njëra-tjetrën dhe si mund të trajtohen këto situata në mënyrë të drejtë. Gjithashtu, do të trajtojmë çështjen e kufizimit të të drejtave, duke kuptuar se kur dhe si, në</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojë situatat ku të drejtat mund të hyjnë në konflikt me njëra-tjetrën dhe të diskutoni qasjet e mundshme për zgjidhjen e këtyre konflikteve. • Të shpjegojë parimet dhe rastet kur të drejtat e njeriut mund të kufizohen ligjërisht, duke kuptuar rëndësinë e proporcionalitetit dhe legjitimitetit të kufizimeve. • Të trajtojnë e të interpretojnë disa nga të drejtat themelore të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to: <ul style="list-style-type: none"> • E drejta për të jetuar dhe për ruajtjen e integritetit fizik dhe moral të individit. • E drejta e shprehjes, lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë. • E drejta për t'u informuar. • E drejta për t'u arsimuar. • E drejta për punë. • E drejta për t'u organizuar. • E drejta e votës • E drejta për të gëzuar një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët. • E drejta e mbrojtjes së të dhënave personale 	<p>kulturore janë thelbësore për një jetë dinjitoze.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të demonstrojnë aftësinë për të diskutuar dhe debatuar për çështje të të drejtave të njeriut në mënyrë të respektueshme, edhe kur ka konflikte mes të drejtave. Kërkoni zgjidhje paqësore dhe konstruktive. • Të nxisin pjesëmarrjen aktive në komunitet dhe në shoqërinë civile, duke ndihmuar në forcimin e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore, duke filluar nga shkolla dhe familja.
---	---	--

<p>rrethana të caktuara, të drejtat mund të kufizohen ligjërisht, gjithmonë me kusht që të respektohen parimet themelore.</p> <p>Në fund, do të sjellim fokusin në kontekstin shqiptar, duke analizuar disa nga të drejtat themelore të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Shqipërisë. Këtu do të përfshijmë të drejta jetike si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejta për të jetuar dhe për ruajtjen e integritetit fizik dhe moral. • Liria e shprehjes, e ndërgjegjes dhe e fesë. • E drejta për t'u informuar. • E drejta për t'u arsimuar. • E drejta për punë. • E drejta për t'u organizuar (p.sh., në shoqata apo sindikata). • E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. • E drejta për të gëzuar një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët. 	<ul style="list-style-type: none"> • E drejta për një proces të rregullt gjyqësor. • E drejta e pronësisë intelektuale etj. 	
--	---	--

<ul style="list-style-type: none"> E drejta për një proces të rregullt gjyqësor, e cila garanton drejtësinë. <p>1 Ky kapitull synon t'ju pajisë me njohuri thelbësore për të kuptuar dhe vlerësuar të drejtat e njeriut si shtylla të një shoqërie demokratike dhe të drejtë.</p>		
TEMA SISTEMI GJYQËSOR DHE ORGANET QË LIDHEN ME TË 3 orë		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime e sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>Sistemi gjyqësor është shtylla kryesore e drejtësisë në çdo shtet dhe në këtë kapitull do të thellohem në funksionimin e tij. Do të kuptojmë organizimin dhe funksionet e tre shkallëve të gjyqësorit: Gjykata e Shkallës së Parë, ku nisin çështjet; Gjykata e Apelit, e cila rishikon vendimet e shkallës së parë; dhe Gjykata e Lartë, organi më i lartë gjyqësor që siguron njëtrajtshmërinë e zbatimit të ligjit. Do</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të përshkruajë organizimin dhe funksionet kryesore të sistemit gjyqësor në Shqipëri, duke theksuar rolin e Gjykatave të Shkallës së Parë, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Të shpjegojë sistemin si një tërësi funksionale, jo thjesht si shumë pjesësh të shkëputura 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> Të pranojnë sistemin si një tërësi funksionale, jo thjesht si pjesë të shkëputura të pranojnë se një vendim i një gjykate më të ulët mund të

<p>të mësojmë për kompetencat specifike të secilës gjykatë dhe procesin e ankimit si një e drejtë themelore për rishikimin e vendimeve. Një theks i veçantë do t'i vihet pavarësisë së sistemit gjyqësor, duke shpjeguar pse kjo pavarësi është jetike për një drejtësi të paanshme dhe të besueshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojë që pavarësia mbron qytetarët nga vendimet arbitrare të qeverisë • Të identifikojë dhe të shpjegojë kompetencat specifike të secilës shkallë gjykate dhe llojet e çështjeve që ato shqyrtojnë. • Të argumentojë rëndësinë e pavarësisë së sistemit gjyqësor si një garanci thelbësore për drejtësinë dhe shtetin e së drejtës. • Të shpjegojë procesin e ankimit dhe rëndësinë e tij si një mjet për rishikimin e vendimeve gjyqësore dhe garantimin e drejtësisë. • Të lidhë strukturën e sistemit gjyqësor me jetën e përditshme • Të argumentojë që ligji nuk është vetëm teori, por ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën tonë. 	<p>rishikohet nga një gjykatë më e lartë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojë pavarësinë gjyqësore si baza e funksionimit të shtetit të së drejtës. • Të pranojë që drejtësia mund të arrihet vetëm nëpërmjet një sistemi të lirë nga ndikimet • Të besojnë tek procesi i ankimit si një mekanizëm i rëndësishëm, për një mundësi të dytë për drejtësi.
<p>Pjesë thelbësore e sistemit të drejtësisë janë edhe Prokuroria dhe Avokati (Mbrojtësi). Do të eksplorohet roli dhe funksionet e Prokurorisë si institucion që heton veprat penale dhe përfaqëson akuzën, si dhe mënyrën</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë rolin dhe funksionet kryesore të Prokurorisë në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë hetimin e veprave penale dhe përfaqësimin e akuzës. 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë që organet e drejtësisë janë pjesë e një sistemi

<p>se si ajo organizohet dhe bashkëpunon me Policinë Gjyqësore.</p> <p>Nga ana tjetër, do të kuptojmë rëndësinë e Avokatit, si garantues i të drejtës së mbrojtjes për çdo individ. Do të shohim se cilat janë të drejtat e mbrojtësit dhe si etika profesionale udhëheq marrëdhëniet e tij me të mbrojturin. Përveç këtyre, do të njihemi me rolin e noterisë, e cila luan një rol kyç në ligjshmërinë dhe vërtetësinë e veprimeve juridike</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë organizimin e Prokurorisë dhe hierarkinë e saj. • Të identifikojë kompetencat kryesore të Prokurorisë. • Të përshkruajë rolin dhe kompetencat e Policisë Gjyqësore si një organ në vartësi të Prokurorisë për kryerjen e hetimeve. • Të përkufizojë rolin e mbrojtësit (avokatit) dhe rëndësinë e tij në procesin gjyqësor për garantimin e të drejtave të palëve. • Të përshkruajë dhe të argumentojë rëndësinë e të drejtës së mbrojtjes si një parim themelor në çdo proces të rregullt ligjor. • Të identifikojë të drejtat kryesore të mbrojtësit gjatë ushtrimit të profesionit të tij. • Të diskutojë marrëdhëniet e mbrojtësit me klientin e tij dhe rëndësinë e etikës së mbrojtjes në ruajtjen e besueshmërisë së profesionit. 	<p>që bashkëpunojnë dh e kontrollojnë njëri-tjetrin</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të respektojnë idenë që drejtësia arrihet vetëm përmes një procesi të rregullt ligjor dhe kur mbrohen të gjitha palët. • Të vlerësojnë e të respektojnë rregullat e sjelljes profesionale si garanci për drejtësinë
<p>Noteria dhe zgjidhjet jashtëgjyqësore të konflikteve</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të</p>

<p>Së fundi, do të shqyrtojmë alternativat e zgjidhjes së konflikteve jashtëgjyqësore, siç është ndërmjetësimi. Do të kuptojmë se çfarë është ndërmjetësimi, si funksionon dhe në cilat raste mund të aplikohet si një mënyrë më e shpejtë dhe më efikase për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Gjithashtu, do të flasim për ndikimin e opinionit publik në mënyrën se si trajtohen dhe zgjidhen konfliktet në shoqëri, duke theksuar rëndësinë e ndërgjegjësimit qytetar për një sistem drejtësie efikas dhe transparent.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë kuptimin e noterisë dhe shpjegoni rolin thelbësor të saj në garantimin e ligjshmërisë dhe vërtetësisë së veprimeve juridike, si kontratat apo testamentet. • Të përkufizojë konceptin e zgjidhjes së konflikteve në rrugë jashtëgjyqësore si një alternativë ndaj procesit gjyqësor. • Të identifikojë mënyrat kryesore të realizimit të zgjidhjes jashtëgjyqësore, duke theksuar rolin e ndërmjetësimit. • Të përshkruajë rastet dhe situatat ku metoda e ndërmjetësimit është e aplikueshme dhe e dobishme. • Të vlerësojë rolin e opinionit publik në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve, si dhe ndikimin e tij në ndërgjegjësimin ligjor. 	<p>demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • procedurat e sakta ligjore shërbejnë për të mbrojtur të gjithë palë • të kërkojnë zgjidhje që janë më të shpejta, më pak të kushtueshme dhe më efikase për palët. • Të shprehin dëshirën e vullnetin për të kuptuar dinamikat midis shoqërisë, opinionit publik dhe sistemit ligjor. • Të shprehin vullnetin për të shmangur konfuzionin dhe për të siguruar një kuptim të qartë të termave dhe koncepteve. • Të pranojnë zgjidhjen jashtëgjyqësore të konfliktit si një alternativë e procesit gjyqësor • Të pranojë rolin e opinionit publik në krijimin por dhe në
--	---	---

zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve, si dhe ndikimin e tij në ndërgjegjësimin ligjor.

E DREJTA PENALE DHE DREJTËSIA PËR TË MITUR

10 orë

Njohuri	Aftësi	Qëndrime e sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>Kuptimi i qëllimit dhe koncepteve themelore të kodit Penal</p> <p>Kjo temë synon të pajisë nxënësit me njohuri për konceptet themelore të së drejtës penale, duke përkufizuar Kodin Penal si ligjin që përcakton veprat penale dhe dënimet përkatëse.</p> <p>Nxënësit do të kuptojnë rëndësinë thelbësore të këtij Kodi për mbrojtjen e shoqërisë, ruajtjen e rendit dhe parandalimin e krimit.</p> <p>Për më tepër, nxënësit do të identifikojnë dhe shpjegojnë koncepte kyçe si vepra penale,</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë Kodin Penal si ligjin që përcakton veprat penale (krimet) dhe dënimet • Të shpjegojë rëndësinë e tij për mbrojtjen e shoqërisë, ruajtjen e rendit dhe parandalimin e krimit. • Të identifikojë konceptet thelbësore si vepra penale, autor, bashkëpunëtor dhe dallimin ndërmjet veprimeve të kryera me dashje dhe me pakujdesi. • Të shpjegojë parimin e ligjshmërisë ("Nuk ka krim pa ligj") dhe rëndësinë e tij për drejtësinë penale. 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përpiqen të njihen më thellë me nenet e Kodit penal dhe të çdo ligji tjetër për të jetuar një jetë në respektim të ligjit ose për të sugjeruar përmirësime të tij në përputhje me kërkesat në ndryshim të realitetit

<p>autor, bashkëpunëtor, si dhe dallimin thelbësor midis veprimeve të kryera me dashje dhe me pakujdesi.</p> <p>Një pjesë e rëndësishme e kapitullit do t'i kushtohet shpjegimit të parimit të ligjshmërisë ("Nuk ka krim pa ligj") dhe rëndësisë së tij për garantimin e drejtësisë penale.</p>		<ul style="list-style-type: none"> • Të respektojnë parimet e të drejtës penale për të qenë promotorë të krijimit dhe konsolidimit të një shteti të së drejtës
<p>Kuptimi i përgjegjësisë penale të të miturve dhe të pasojave të tyre</p> <p>Kjo temë trajton thellësisht përgjegjësinë penale, me një fokus të veçantë te trajtimi i të miturve në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Nxënësit do të rikujtojnë moshën e përgjegjësisë penale në Shqipëri dhe do të shpjegojnë ndryshimet në trajtimin e të miturve (14-18 vjeç) krahasuar me të rriturit.</p> <p>Ata do të identifikojnë llojet e ndryshme të dënimeve dhe masave edukative që zbatohen për të miturit, duke theksuar rëndësinë e riedukimit dhe ri integritit.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rikujtojnë moshën e përgjegjësisë penale në Shqipëri dhe të shpjegojnë sesi të miturit (14-18 vjeç) trajtohen ndryshe nga të rriturit në sistemin e drejtësisë penale. • Të identifikojnë llojet e ndryshme të dënimeve dhe masave edukative që zbatohen për të miturit, duke theksuar fokusin tek riedukimi dhe ri integriti. • Të vlerësojnë pasojat afatgjata të një veprë penale (p.sh., ndikimi në reputacion, në mundësitë e punësimit, në udhëtime) si për veten ashtu edhe për viktimën dhe shoqërinë 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nga nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin një qëndrim aktiv në parandalimin e veprave penale, duke ndihmuar veten dhe të tjerët të shmangin përfshirjen në situata të tilla. • Të mbështesin proceset e riedukimit dhe ri integritit të të miturve, duke besuar në mundësinë e ndryshimit dhe

<p>Për më tepër, kapitulli do të nxisë nxënësit të vlerësojnë pasojat afatgjata të një vepre penale, si ndikimi në reputacion, mundësitë e punësimit dhe udhëtimet, si për autorin ashtu edhe për viktimën dhe shoqërinë.</p>		<p>përmirësimit.</p>
<p>Konceptet themelore të drejtësisë restauruese</p> <p>Ky kapitull do të prezantojë nxënësit me konceptin e drejtësisë restauruese, duke e përkufizuar atë si një qasje ndaj drejtësisë që fokusohet te riparimi i dëmit dhe përfshirja e viktimës, autorit dhe komunitetit.</p> <p>Ata do të zhvillojnë aftësinë për të krahasuar dhe kundërshtuar modelin e drejtësisë restauruese me modelin tradicional të drejtësisë penale, duke theksuar ndryshimin e fokusit nga ndëshkimi te riparimi.</p> <p>Për më tepër, nxënësit do të identifikojnë palët kryesore të përfshira në procesin e drejtësisë restauruese (viktimën, autorin, komunitetin) dhe do të shpjegojnë rolin e</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë dhe shpjegojë konceptin e drejtësisë restauruese si një qasje ndaj drejtësisë që përqendrohet te riparimi i dëmit dhe përfshirja e viktimës, autorit dhe komunitetit. • Të krahasojë dhe të kundërshtojë modelin e drejtësisë restauruese me modelin tradicional të drejtësisë penale, duke theksuar ndryshimin e fokusit nga ndëshkimi te riparimi. • Të identifikojë palët kryesore të përfshira në procesin e drejtësisë restauruese (viktimën, autorin, komunitetin) dhe të shpjegojnë rolin e secilës. 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nga nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojnë konceptin e drejtësisë restauruese si një qasje që fokusohet te riparimi i dëmit të shkaktuar dhe jo vetëm te ndëshkimi i autorit. • Të shfaqin një qëndrim mbështetës ndaj zgjidhjes së problemeve të shkaktuara nga veprat penale, duke kërkuar përfshirjen e të gjitha palëve të prekura. • Të kenë empati ndaj viktimës,

<p>secilës, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit për zgjidhje të qëndrueshme.</p>		<p>duke kuptuar nevojat e saj për riparim dhe rikuperim.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mbështesin idenë se autorët duhet të marrin përgjegjësi aktive për veprimet e tyre dhe të kontribuojnë në riparimin e dëmit. • Vlerësim i Rolit të Komunitetit: Të vlerësojnë rolin thelbësor të komunitetit në procesin e drejtësisë, si në mbështetjen e viktimave ashtu edhe në ri integrimin e autorëve. • Të jenë të hapur ndaj modeleve alternative të drejtësisë, siç është drejtësia restauruese, duke kuptuar përfitimet e saj krahasuar me sistemin tradicional penal.
<p>Drejtësia restauruese dhe parimi i barazisë para ligjit</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit pritet të</p>

<p>Ky kapitull do të thellojë kuptimin e nxënësve mbi drejtësinë restauruese dhe lidhjen e saj me parimin e barazisë para ligjit. Ata do të zhvillojnë aftësinë për të analizuar sesi drejtësia restauruese, duke u fokusuar te nevojat e barabarta, qasja e individualizuar, pjesëmarrja e barabartë dhe fuqizimi i viktimës, forcon këtë parim themelor. Nxënësit do të mësojnë të shpjegojnë se barazia para ligjit nuk nënkupton trajtim identik për të gjithë, por trajtim të barabartë që merr parasysh rrethanat specifike, veçanërisht në kontekstin e drejtësisë restauruese. Për më tepër, ata do të jenë në gjendje të diskutojnë sesi drejtësia restauruese mund të trajtojë pabarazitë ekzistuese në sistemin tradicional penal, si diskriminimi sistematik dhe stigmatizimi, duke ofruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë sesi drejtësia restauruese forcon parimin e barazisë para ligjit duke u fokusuar te nevojat e barabarta, qasja e individualizuar, pjesëmarrja e barabartë dhe fuqizimi i viktimës. • Të shpjegojë se barazia para ligjit nuk nënkupton trajtim identik për të gjithë, por trajtim të barabartë duke marrë parasysh rrethanat specifike, veçanërisht në kontekstin e drejtësisë restauruese. • Të diskutojë si drejtësia restauruese mund të trajtojë pabarazitë ekzistuese në sistemin tradicional penal, si diskriminimi sistematik dhe stigmatizimi 	<p>demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojnë sesi drejtësia restauruese forcon parimin e barazisë para ligjit duke u fokusuar te nevojat e barabarta, qasja e individualizuar, pjesëmarrja e barabartë dhe fuqizimi i viktimës. • Të kuptojnë dhe pranojnë se barazia para ligjit nuk nënkupton trajtim identik për të gjithë, por trajtim të barabartë duke marrë parasysh rrethanat specifike, veçanërisht në kontekstin e drejtësisë restauruese. • Të jenë të ndërgjegjshëm për aftësinë e drejtësisë restauruese për të trajtuar pabarazitë ekzistuese në sistemin tradicional penal, si diskriminimi
--	--	--

		<p>sistematik dhe stigmatizimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mbështesin qasjet humanitare dhe të individualizuara në drejtësinë penale, veçanërisht për të miturit. • Të shfaqin një angazhim për drejtësi sociale dhe barazi, duke kuptuar rolin e drejtësisë restauruese në arritjen e këtyre qëllimeve.
<p>Drejtësia restauruese dhe drejtësia për të mitur</p> <p>Kjo temë do të thellojë konceptin e drejtësisë restauruese, duke argumentuar pse ajo është veçanërisht e përshtatshme për të miturit, duke marrë parasysh moshën, pjekurinë dhe potencialin e tyre për riedukim.</p> <p>Nxënësit do të identifikojnë ndryshimin thelbësor të filozofisë nga një qasje "dënuese" në një qasje "mbështetëse" kur bëhet fjalë për fëmijën autor në drejtësinë restauruese. Ata</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojë pse drejtësia restauruese është veçanërisht e përshtatshme për të miturit, duke marrë parasysh moshën, pjekurinë dhe potencialin e tyre për riedukim. • Të identifikojë ndryshimin e filozofisë nga "dënues" në "mbështetës" kur bëhet fjalë për fëmijën autor në drejtësinë restauruese. • Të shpjegojë sesi drejtësia restauruese synon të shmangë burgimin për të miturit dhe të ofrojë 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nga nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mbështesin qasjen e drejtësisë restauruese e përshtatshme për të miturit, duke marrë parasysh moshën, pjekurinë dhe potencialin e tyre për riedukim. • Të kontribuojnë në në

<p>do të shpjegojnë sesi kjo qasje synon të shmangë burgimin për të miturit, duke ofruar alternativa të mbështetura te komuniteti, si ndërmjetësimi, riparimi i dëmit dhe shërbimi në komunitet. Për më tepër, kapitulli do të analizojë sesi drejtësia restauruese kontribuon në parandalimin e viktimizimit të ardhshëm dhe ri integrimin social të autorëve fëmijë, duke siguruar barazi në siguri dhe mundësi, si dhe do të vlerësojë rolin thelbësor të komunitetit në këtë proces.</p>	<p>alternativa që mbështeten te komuniteti (p.sh., ndërmjetësimi, riparimi i dëmit, shërbimi në komunitet).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë sesi drejtësia restauruese kontribuon në parandalimin e viktimizimit të ardhshëm dhe ri integrimin social të autorëve fëmijë, duke siguruar barazi në siguri dhe mundësi. • Të vlerësojë rolin e komunitetit në procesin e drejtësisë restauruese për të miturit dhe sesi përfshirja e tij mund të sigurojë zgjidhje më të përshtatura dhe të nxisë ndërgjegjësimin. 	<p>parandalimin e viktimizimit të ardhshëm dhe ri integrimin social të autorëve fëmijë, duke siguruar barazi në siguri dhe mundësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përfshihen në komunitetin ku jetojnë për të siguruar zgjidhjet e duhura për të miturit dhe drejtësinë
<p>Sfidat psikologjike dhe sociale në drejtësinë për të mitur</p> <p>Kjo temë thellohet në kuptimin e sjelljes kriminale te fëmijët autorë, duke analizuar shkaqet e mundshme të mungesës së ndjenjës së fajit apo turpit, si trauma, mungesa emocionale apo ndjenja e pabarazisë sociale. Nxënësit do të shpjegojnë sesi drejtësia restauruese ofron një qasje alternative, duke trajtuar mentalitetin "bota është e egër dhe</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë dhe të diskutojë shkaqet e mundshme të mungesës së ndjenjës së fajit ose turpit tek autori fëmijë, përfshirë traumën, mungesën emocionale ose ndjenjën e pabarazisë sociale. • Të shpjegojnë sesi drejtësia restauruese trajton mentalitetin "bota është e egër dhe duhet të hash ose të të hanë" duke theksuar përballjen me pasojat 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nga nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqë empati me autorin fëmijë për ndjesitë dhe sfidat me të cilat janë përballur. • Të pranojnë qasjen e efektshme të drejtësisë restauruese • Të propozojnë strategji për

<p>duhet të hash ose të të hanë" përmes përballjes me pasojat reale dhe përgjegjshmërisë aktive, si takimet me viktimën apo qarqet restauruese.</p> <p>Gjithashtu, do të analizohet sesi përqendrimi te fitimi i çastit dhe mungesa e perspektivës afatgjatë ndikojnë te sjellja kriminale e të miturve, dhe sesi drejtësia restauruese, përmes riedukimit dhe ri integritit, synon të krijojë një ndjenjë qëllimi dhe mundësish afatgjata.</p> <p>Në fund, nxënësit do të aftësohen dhe do të nxiten për të propozuar strategji konkrete për trajtimin e fëmijëve autorë që shfaqin këto sfida, duke përfshirë krijimin e një lidhjeje besimi, trajtimin e shkaqeve rrënjësore (p.sh., terapi), dhe përfshirjen e familjes dhe komunitetit.</p>	<p>reale dhe përgjegjshmërinë aktive (p.sh., përmes takimeve me viktimën ose qarqeve restauruese).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojnë sesi përqendrimi tek fitimi i çastit dhe mungesa e perspektivës afatgjatë ndikojnë te sjellja kriminale e të miturve dhe sesi drejtësia restauruese, përmes riedukimit dhe ri integritit, synon të krijojë një ndjenjë qëllimi dhe mundësish afatgjata. • Të propozojnë strategji për trajtimin e fëmijëve autorë që shfaqin këto sfida, duke përfshirë krijimin e një lidhjeje besimi, trajtimin e shkaqeve rrënjësore (p.sh., terapi), dhe përfshirjen e familjes dhe komunitetit. 	<p>trajtimin e fëmijëve autorë që shfaqin këto sfida, duke përfshirë krijimin e një lidhjeje besimi, trajtimin e shkaqeve rrënjësore (p.sh., terapi), dhe përfshirjen e familjes dhe komunitetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin besim në potencialin e fëmijëve autorë për ndryshim dhe ri integrimin, duke mbështetur qasjet që synojnë analizën e shkaqeve themelore të sjelljes kriminale.
<p>Parandalimi i viktimizimit të dytë te fëmijët</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë dhe të shpjegojë konceptin e 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nga nxënësit pritet të</p>

<p>Kjo temë përqendrohet në rëndësinë e parandalimit të viktimizimit të dytë të fëmijët.</p> <p>Nxënësit do të mësojnë të përkufizojnë dhe shpjegojnë këtë koncept, si dhe të analizojnë ndikimin negativ që ai ka në shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve (si ankthi, depresioni, çrregullimet e të ngrënit, dhe PTSD).</p> <p>Gjithashtu, ata do të kuptojnë sesi parandalimi i viktimizimit të dytë ndikon në rritjen e besimit të fëmijëve te sistemi i drejtësisë dhe inkurajon raportimin e krimeve.</p> <p>Tema analizon lidhjen midis viktimizimit të dytë dhe shfaqjes së problemeve të sjelljes (si izolimi, agresiviteti, abuzimi me substancat), si dhe do të vlerësojë rëndësinë e parandalimit të tij për ri integrimin social të shëndetshëm të fëmijëve viktimë.</p>	<p>viktimizimit të dytë të fëmijët.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë ndikimin negativ të viktimizimit të dytë në shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve (p.sh., ankthi, depresioni, çrregullimet e të ngrënit, PTSD). • Të shpjegojë sesi parandalimi i viktimizimit të dytë ndikon në rritjen e besimit të fëmijëve te sistemi i drejtësisë. • Të diskutojë sesi shmangia e viktimizimit të dytë inkurajon fëmijët të raportojnë krimet dhe të kërkojnë ndihmë. • Të analizojë lidhjen midis viktimizimit të dytë dhe shfaqjes së problemeve të sjelljes (p.sh., izolimi, agresiviteti, abuzimi me substancat) të fëmijët. • Të vlerësojë rëndësinë e parandalimit të viktimizimit të dytë për ri integrimin social të shëndetshëm të fëmijëve viktimë. 	<p>demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jenë të më të vetëdijshëm për ndikimin negativ të viktimizimit të dytë në shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve (p.sh., ankthi, depresioni, çrregullimet e të ngrënit, PTSD), duke shfaqur empati dhe ndjeshmëri. • Të shprehin besim të rritur tek sistemi i drejtësisë, duke promovuar një mjedis mbështetës. • Të jenë më guximtarë të raportojnë krimet dhe të kërkojnë ndihmë, duke theksuar rëndësinë e një mjedisi të sigurt. • Të vlerësojnë rëndësinë e parandalimit të viktimizimit të dytë për ri integrimin social të shëndetshëm të fëmijëve
--	--	---

		viktimë, duke shfaqur gatishmëri për të ofruar mbështetje.
TEMATIKA: E DREJTA E PRONËS		
5 orë		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime Sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>Kuptimi i pronës dhe llojet e saj</p> <p>Kjo temë do të prezantojë nxënësit me konceptin themelor të pronës, duke i ndihmuar ata të përkufizojnë dhe të dallojnë qartë pronën private nga ajo publike, si dhe të kuptojnë rëndësinë e mbrojtjes ligjore të saj si një e drejtë themelore.</p> <p>Një fokus i veçantë do t'i kushtohet pronës intelektuale, ku nxënësit do të identifikojnë dhe shpjegojnë format kryesore si të drejtat e autorit dhe markat tregtare, duke kuptuar pse ato konsiderohen "pronë" dhe duhet të mbrohen ligjërisht.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë konceptin e pronës • Të dallojë pronën private dhe pronën publike, duke dhënë shembuj për secilën. • Të shpjegojë rëndësinë e mbrojtjes ligjore të pronës si një e drejtë themelore. • Të shpjegojë që të drejtat e autorit dhe markat tregtare janë forma të rëndësishme të pronës. • Të identifikojë format kryesore të pronës intelektuale (p.sh., të drejtat e autorit, markat tregtare) 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin respekt të palëkundur për pronën private të individëve dhe të mos ndërhyjnë apo dëmtojnë atë. • Të demonstrojnë përgjegjshmëri dhe kujdes ndaj pronës publike, duke e konsideruar atë si pasuri të përbashkët që duhet ruajtur dhe mirëmbajtur.

<p>Për më tepër, kapitulli do të trajtojë shkeljet ligjore të të drejtave të pronësisë intelektuale, duke analizuar pasojat ligjore dhe etike që vijnë nga këto shkelje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë që format e pronës intelektuale konsiderohen "pronë" dhe duhen mbrojtur ligjërisht. • Të identifikojnë disa nga shkeljet ligjore të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe pasojat ligjore dhe etike të të shkeljes së tyre 	<ul style="list-style-type: none"> • Të demonstrojnë sjellje në mbrojtje të të drejtave të pronës, si të tyre ashtu edhe të të tjerëve, në kuadër të ligjit. • Të demonstrojnë besim te sistemi ligjor si mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pronësore dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. • Të vlerësojnë punën krijuese dhe inovacionin • Të shfaqin respekt për pronën intelektuale të të tjerëve, duke shmangur plagjiaturën apo përdorimin e paautorizuar të veprave dhe markave. • Të promovojnë kulturën e ndershmërisë dhe të origjinalitetit.
--	--	--

<p>Veprat penale kundër pronës dhe pasojat ligjore</p> <p>Ky kapitull do të përqendrohet në veprat penale kundër pronës dhe pasojat e tyre ligjore.</p> <p>Nxënësit do të mësojnë të listojnë dhe të përshkruajnë karakteristikat kryesore të veprave më të zakonshme si vjedhja, dëmtimi i pronës/vandalizmi dhe përvetësimi i paligjshëm.</p> <p>Ata do të dallojnë qartë pasojat penale (gjobë, masa edukative, burgim) nga ato civile (dëmshpërblim) dhe do të analizojnë sesi faktorë si vlera e pronës, rrethanat e veprës dhe përsëritja ndikojnë në ashpërsinë e dënimeve.</p> <p>Gjithashtu, kapitulli do të shpjegojë konceptet e piraterisë digjitale dhe plagjiaturës, duke diskutuar pasojat e tyre ligjore dhe etike.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rendisë veprat penale më të zakonshme kundër pronës (p.sh., vjedhja, dëmtimi i pronës/vandalizmi, përvetësimi i paligjshëm) dhe përshkruajnë karakteristikat kryesore të secilës. • Të dallojë midis pasojave penale (p.sh., gjobë, masa edukative, burgim) dhe civile (p.sh., detyrimi për dëmshpërblim) të kryerjes së një vepre kundër pronës. • Të analizojë sesi vlera e pronës, rrethanat e veprës dhe përsëritja e saj ndikojnë në ashpërsinë e dënimeve ligjore. • Të shpjegojë konceptet e piraterisë digjitale (vjedhja e pronës intelektuale online) dhe plagjiaturës, si dhe diskutojnë pasojat ligjore dhe etike të tyre. 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin një refuzim të prerë ndaj çdo lloj vepre kundër pronës (vjedhja, dëmtimi, vandalizmi, përvetësimi i paligjshëm), duke kuptuar natyrën e tyre kriminale. • Të pranojnë si të ligjshme pasojat e ndryshme ligjore, si penale (gjobë, burgim) ashtu edhe civile (dëmshpërblim), që vijnë nga kryerja e veprave kundër pronës. • Të pranojnë si të ligjshme se ashpërsia e dënimeve ligjore ndikohet nga vlera e pronës, rrethanat e veprës dhe përsëritja e saj, duke vlerësuar parimet e drejtësisë.
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë që pirateria digjitale dhe plagjiatura janë forma të vjedhjes së pronës intelektuale online dhe të refuzojnë t'i praktikojnë ato. • Të demonstrojnë etikë të lartë në përdorimin e burimeve digjitale, duke respektuar të drejtat e autorit dhe duke promovuar origjinalitetin. • Të demonstrojnë sjellje që tregojnë respekt për pronën, si materiale ashtu edhe intelektuale, në mjedisin e tyre shoqëror dhe digjital.
<p>Kostoja reale dhe ndikimi social i dëmtimit të pronës publike</p> <p>Kjo tematikë do të theksojë rëndësinë e ruajtjes së pronës publike, duke ndërgjegjësuar nxënësit për pasojat e dëmtimit të saj.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të llogarisë (në baza hipotetike) kostot financiare të riparimit ose zëvendësimit të pronës së dëmtuar publike (p.sh., dëmtimi i stolave në park, grafitë në 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë se dëmtimi i pronës publike ka kosto financiare direkt (riparim, zëvendësim) që

<p>Ata do të mësojnë të llogarisin në mënyrë hipotetike kostot financiare të riparimit ose zëvendësimit të pronës së dëmtuar publike, si stolat në park apo grafitet në mure, dhe të kuptojnë sesi këto shpenzime bien mbi taksapaguesit dhe komunitetin.</p> <p>Për më tepër, do t'i ndihmojë nxënësit të identifikojnë dhe të përshkruajnë ndikimet sociale dhe psikologjike të vandalizmit, si ulja e sigurisë, shëmtimi i mjedisit dhe ndikimi negativ në cilësinë e jetës.</p> <p>Në fund, ata do të jenë në gjendje të argumentojnë bindshëm se dëmtimi i pronës publike është një akt kundër të gjithë komunitetit, duke dëmtuar shërbimet dhe burimet që përdoren nga të gjithë.</p>	<p>mure shkolle) dhe shpjegojnë sesi këto kosto bien mbi taksapaguesit/komunitetin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë e të përshkruajë ndikimet (pasojat) sociale dhe psikologjike të dëmtimit të pronës publike (p.sh., ulja e sigurisë, shëmtimi i mjedisit, mungesa e respektit, ndikimi në cilësinë e jetës) tek komuniteti. • Të argumentojë se dëmtimi i pronës publike është një akt kundër të gjithë komunitetit dhe dëmton shërbimet që përdorin të gjithë. 	<p>bien mbi taksapaguesit dhe komunitetin në tërësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin një angazhim të fortë për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e pronës publike, duke e konsideruar dëmtimin e saj si një akt kundër të gjithë komunitetit dhe shërbimeve që përdorin të gjithë. • Të denoncojnë shkeljet dhe aktet e vandalizmit nga pronës publike, duke u bërë model i respektit të saj
<p>Roli i qytetarit në mbrojtjen e pronës publike</p> <p>Kjo temë përqendrohet në rolin aktiv të qytetarëve në mbrojtjen e pronës, duke i pajisur nxënësit me strategji efektive për</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë strategji efektive për parandalimin e dëmtimit dhe vjedhjes së pronës, si në nivel 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritjet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojnë dhe të zbatojnë strategji efektive për

<p>parandalimin e dëmtimit dhe vjedhjes, si në nivel personal ashtu edhe në atë komunitar.</p> <p>Ata do të mësojnë rëndësinë e denoncimit të akteve të tilla dhe do të identifikojnë kanalet e duhura për të bërë një denoncim.</p> <p>Për më tepër, nxënësit do të aftësohen të të demonstrojnë një ndjenjë të fortë të përgjegjësisë qytetare për mbrojtjen e pronës publike dhe private, si dhe do të nxiten të propozojnë dhe të marrin pjesë në nisma komunitare ose shkollore që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e pasurive të përbashkëta.</p>	<p>personal ashtu edhe në nivel komuniteti (p.sh., siguria, vetëdija, rolet e dëshmitarëve).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë rëndësinë e denoncimit të akteve të dëmtimit ose vjedhjes së pronës dhe të identifikojnë kanalet e duhura për të bërë një denoncim. • Të demonstrojnë ndjenjën e përgjegjësisë qytetare për mbrojtjen e pronës publike dhe private. • Të propozojnë nisma komunitare ose shkollore që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e pronës publike (p.sh., fushata pastrimi, projekte artistike për abuzimin me grafitet). 	<p>parandalimin e dëmtimit dhe vjedhjes së pronës, si në nivel personal (p.sh., siguria e pronës së tyre) ashtu edhe në nivel komuniteti (p.sh., vetëdija, rolet e dëshmitarëve aktivë).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë rëndësinë e denoncimit të akteve të dëmtimit ose vjedhjes së pronës dhe të jenë të gatshëm të identifikojnë dhe të përdorin kanalet e duhura për të bërë një denoncim. • Të jenë mbështetës aktiv në propozimin dhe pjesëmarrjen në nisma komunitare ose shkollore që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e pronës publike (p.sh., fushata pastrimi, projekte artistike për abuzimin me grafitet).
---	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> • Të bëhen mbrojtës të një mjedisi të pastër dhe të ruajtur, duke inkurajuar shokët dhe familjarët të respektojnë pronën dhe të kontribuojnë në mirëqenien e komunitetit.
<p>IA gjeneruese dhe e drejta e autorit</p> <p>Kjo tematikë do t'i prezantojë nxënësit me botën e Inteligjencës Artificiale Gjeneruese, duke përkufizuar konceptin dhe shpjeguar shkurtimisht funksionimin e saj.</p> <p>Një theks i veçantë do t'i kushtohet ndërgjegjësimit për rreziqet kryesore të përdorimit të papërgjegjshëm, si dezinformimi (fake neës, deepfakes), krijimi i përmbajtjes së paligjshme/të dëmshme dhe mashtrimi akademik (plagjiatura), si dhe do të analizohet ndikimi potencial i saj në shoqëri, informacionin publik dhe marrëdhëniet ndërpersonale.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë Inteligjencën Artificiale Gjeneruese dhe të shpjegojë shkurtimisht sesi ajo funksionon. • Të identifikojnë rreziqet kryesore të përdorimit të papërgjegjshëm të IA-së gjeneruese, duke përfshirë dezinformimin (fake neës, deepfakes), krijimin e përmbajtjes së paligjshme/të dëmshme, dhe mashtrimin akademik (plagjiaturën). • Të analizojë ndikimin potencial të përmbajtjes së gjeneruar nga IA në shoqëri, në informacionin publik dhe në marrëdhëniet ndërpersonale. • Të shpjegojë lidhjen ndërmjet IA-së gjeneruese dhe të drejtës së autorit (pronësisë intelektuale). 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë rreziqet kryesore të përdorimit të papërgjegjshëm të IA-së gjeneruese, si dezinformimi (fake neës, deepfakes), krijimi i përmbajtjes së paligjshme/të dëmshme dhe mashtrimi akademik (plagjiatura). • Të pranojnë dhe të respektojnë të drejtën e autorit dhe t/ drejtat e pronësisë industriale (pronësisë intelektuale) dhe të shfaqin

<p>Gjatë trajtimit të kësaj tematike, do të shpjegohet lidhja komplekse midis IA-së gjeneruese dhe të drejtës së autorit, duke diskutuar dilemat ligjore të trajnimit me vepra të mbrojtura dhe çështjen e pronësisë mbi përmbajtjen e krijuar nga IA.</p> <p>Në fund, nxënësit do të zhvillojnë aftësi për të demonstruar përgjegjësi etike, për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin e gjeneruar nga IA, për të propozuar zgjidhje për përdorimin etik dhe për të reflektuar rreth rolit të tyre si qytetarë digjitalë në mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të pronësisë industriale (patentat për shpikje, markat tregtare dhe dizenjot industriale) dhe luftën kundër abuzimeve me IA-në.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të diskutojë dilemën ligjore të përdorimit të veprave të mbrojtura me të drejtë autori për trajnimin e modeleve të IA-së, duke prezantuar argumentet e krijuesve dhe të zhvilluesve të IA-së. • Të vlerësojë çështjen e pronësisë mbi përmbajtjen e krijuar nga IA-ja dhe shpjegojnë pse legjislacioni aktual shpesh ia atribuon të drejtën e autorit vetëm krijuesve njerëzorë. • Të shpjegojë që plagjiatura e kryer me ndihmën e IA-së mbetet shkelje etike dhe shpesh ligjore. • Të reflektojë për rolin e tij si qytetar digjital në mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe luftën kundër abuzimeve me IA-në 	<p>respekt për të gjatë përdorimit të IA.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të refuzojnë plagjiaturën e kryer me ndihmën e IA-së, duke e konsideruar atë si shkelje etike dhe shpesh ligjore. • Të demonstrojnë përgjegjësi etike në përdorimin e IA-së gjeneruese, duke theksuar rëndësinë e transparencës (deklarimin kur përmbajtja është gjeneruar nga IA). • Të përpiqen të zhvillojnë më tej aftësinë për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin e gjeneruar nga IA dhe për të dalluar të vërtetën nga dezinformimi. • Të propozojnë zgjidhje ose strategji për të promovuar përdorimin etik dhe të
--	--	--

		<p>përgjegjshëm të IA-së në shkollë dhe në komunitet.</p> <p>Të reflektojnë për rolin e tyre si qytetar digjital në mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe luftën kundër abuzimeve me IA-në, duke marrë një qëndrim aktiv.</p>
TEMATIKA: KORRUPSIONI, FORMAT, PASOJAT DHE LUFTA KUNDËR TIJ		
5 orë		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime Sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>Kuptimi i korrupsionit</p> <p>Kjo temë do të prezantojë nxënësit me konceptin themelor të korrupsionit, duke e përkufizuar atë si abuzim me pushtetin për përfitim personal dhe duke shpjeguar Nxënësit do të mësojnë të dallojnë format kryesore të korrupsionit (si ryshfeti,</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë korrupsionin si abuzim me pushtetin e besuar për përfitim personal dhe shpjegojnë pse është një vepër penale. • Të dallojë format kryesore të korrupsionit (p.sh., ryshfeti, abuzimi me detyrën, nepotizmi, konflikti i interesit, trafikimi i ndikimit) dhe japin shembuj 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritet të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë se korrupsioni është një vepër penale dhe abuzim i besimit publik.

<p>nepotizmi, konflikti i interesit) dhe të japin shembuj konkretë.</p> <p>Në këtë temë do të sqarohen e krahasohen "korrupsioni i vogël" me "korrupsionin e madh" dhe do të analizohet ndikimi i tyre të ndryshëm.</p> <p>Po kështu, do të identifikohen sektorët dhe situatat ku korrupsioni është më i pranishëm, shkaqet e tij, si dhe roli i kulturës së reciprocitetit në mbajtjen gjallë të këtij fenomeni</p>	<p>konkretë për secilën formë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të krahasojë "korrupsionin e vogël" me "korrupsionin e madh" dhe të shpjegojë ndikimin e tyre të ndryshëm në jetën e përditshme dhe në nivel kombëtar. • Të identifikojë sektorët ose situatat ku korrupsioni është më i pranishëm (p.sh., shëndetësia, arsimi, doganat, prokurimet publike) në kontekstin lokal dhe kombëtar • Të identifikojë disa nga shkaqet e korrupsionit • Të shpjegojnë se korrupsioni nuk është vetëm një problem individual, por shpesh ka shkaqe sistemike dhe kulturore • Të diskutojnë për rolin e kulturës së reciprocitetit në mbajtjen gjallë të korrupsionit 	<ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin një qëndrim refuzues ndaj çdo forme të korrupsionit, pavarësisht shkallës së tij. • Të jenë vigjilentë dhe të aftë të dallojnë format e ndryshme të korrupsionit (ryshfeti, nepotizmi, konflikti i interesit, etj.) në jetën e përditshme. • Të trajtojnë me seriozitetin e duhur "korrupsionin e vogël" në jetën e tyre dhe atë të "korrupsionit të madh" në zhvillimin kombëtar. • Të ndiejnë empati për viktimat e korrupsionit dhe të kuptojnë se si ai dëmton shoqërinë në tërësi. • Të mirëinformohen vazhdimisht për sektorët dhe situatat ku korrupsioni është më i pranishëm, duke krijuar një
---	--	--

		<p>ndërgjegjësime më të gjerë mbi sfidat.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jenë të gatshëm të diskutojnë hapur rreth shkaqeve të korrupsionit. • Të demonstrojnë integritet personal në veprimet e tyre dhe të refuzojnë të marrin pjesë në praktika korruptive. • Të tregojnë guximin qytetar për të denoncuar korrupsionin, ose të paktën për të mos e toleruar atë.
<p>Identifikimi dhe trajtimi i pasojave të korrupsionit</p> <p>Në këtë temë do të analizohet thellësisht ndikimi shkatërrues i korrupsionit në aspekte të ndryshme të shoqërisë.</p> <p>Nxënësit do të analizojnë pasojat ekonomike të korrupsionit, si rritja e çmimeve, dëmtimi i investimeve dhe thellimi i varfërisë.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë ndikimin e korrupsionit në ekonomi (p.sh., rritja e çmimeve, dëmtimi i investimeve, varfëria). • Të vlerësojë pasojat sociale të korrupsionit (p.sh., humbja e besimit të institucionet, padrejtësia, ulja e cilësisë së shërbimeve publike, nxitja e pabarazisë sociale). 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritet të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë ndikimin negativ të korrupsionit në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale dhe politike

<p>Gjithashtu, do të vlerësohen pasojat sociale, duke përfshirë humbjen e besimit të institucionet, padrejtësinë, uljen e cilësisë së shërbimeve publike dhe nxitjen e pabarazisë sociale.</p> <p>Rëndësi i kushtohet se si korrupsioni dëmton demokracinë dhe shtetin e së drejtës, duke minuar besimin publik dhe duke cenuar zgjedhjet e lira.</p> <p>Në fund, do të diskutohet sesi korrupsioni prek drejtpërdrejt barazinë para ligjit dhe mundësitë e barabarta për të gjithë qytetarët, duke theksuar nevojën për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë sesi korrupsioni dëmton demokracinë dhe shtetin e së drejtës (p.sh., erozioni i besimit publik, cenimi i zgjedhjeve të lira, pamundësia e zbatimit të ligjeve). • Të diskutojë sesi korrupsioni prek drejtpërdrejt barazinë para ligjit dhe mundësitë e barabarta për të gjithë qytetarët. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin një angazhim aktiv për barazinë para ligjit dhe mundësitë e barabarta për të gjithë qytetarët, duke refuzuar çdo formë diskriminimi të shkaktuar nga korrupsioni.
<p>Kuadri ligjor dhe institucional të luftës kundër korrupsionit në Shqipëri</p> <p>Kjo temë përqendrohet në kuadrin ligjor dhe institucional të luftës kundër korrupsionit në Shqipëri.</p> <p>Nxënësit do të identifikojnë ligjet kryesore kombëtare që synojnë parandalimin dhe</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë ligjet kryesore kombëtare që synojnë parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në Shqipëri. • Të përshkruajë rolin e institucioneve kyçe kundër korrupsionit (p.sh., SPAK, GJKKO, KLSH, 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritët të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojnë rëndësinë e ligjeve kryesore kombëtare që synojnë parandalimin dhe ndëshkimin e

<p>ndëshkimin e korrupsionit, si dhe do të përshkruajnë rolin dhe funksionet bazë të institucioneve kyçe antikorrupsion si SPAK, GJKKO, KLSH dhe ILDKPKI.</p> <p>Për më tepër, kapitulli do të rendisë marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare kundër korrupsionit, si Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit, duke i pozicionuar ato si pjesë thelbësore të përpjekjeve globale.</p>	<p>Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave - ILDKPKI) dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë funksionet e tyre bazë të institucioneve kyçe kundër korrupsionit • Të renditë disa nga marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare kundër korrupsionit (p.sh., Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit) si pjesë e përpjekjeve globale. 	<p>korrupsionit në Shqipëri, duke kuptuar rolin e tyre thelbësor në ndërtimin e një shoqërie të drejtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin besim te institucionet kyçe kundër korrupsionit (p.sh., SPAK, GJKKO, KLSH, ILDKPKI) dhe të mbështesin rolin dhe funksionet e tyre bazë në garantimin e llogaridhënies dhe drejtësisë. • Të vlerësojnë rolin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare (p.sh., Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit) në këtë luftë. • Të jenë të gatshëm të kërkojnë llogaridhënie nga institucionet publike dhe të mbështesin përpjekjet për transparence
---	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Të shërbejnë si shembull i një qytetari të informuar dhe aktiv, i cili kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më pak të korruptuar, duke njohur dhe vlerësuar mekanizmat ligjorë dhe institucionalë.
<p>Roli i qytetarit dhe veprimi kundër korrupsionit</p> <p>Ky mësim do të përqendrohet në rolin aktiv të qytetarëve në luftën kundër korrupsionit. Nxënësit do të mësojnë të identifikojnë mënyrat konkrete se si ata, përfshirë të rinjtë, mund të kontribuojnë (p.sh., denoncimi, refuzimi i ryshfetit, kërkesa për transparencë).</p> <p>Ata do të shpjegojnë rëndësinë e integritetit personal dhe etikës, si dhe do të diskutojnë sesi presioni i grupit mund të ndikojë në vendimet korruptive.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë mënyrat se si qytetarët, përfshirë të rinjtë, mund të kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit (p.sh., denoncimi, refuzimi i dhënies/marrjes së ryshfetit, kërkesa për transparencë). • Të shpjegojë rëndësinë e integritetit personal dhe etikës në jetën e përditshme dhe rolin e tyre në parandalimin e korrupsionit. • Të diskutojë sesi presioni i grupit ose mungesa e shpresës mund të ndikojë te vendimi i individit për të toleruar ose marrë pjesë në akte korruptive. • Të propozojnë ide dhe nisma që nxënësit dhe 	<p>as trajtimit të objektivave mbi rolin e qytetarëve dhe etikën, nxënësi pritet të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime qytetare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jenë të gatshëm të ndërmarrin veprime konkrete në luftën kundër korrupsionit, si denoncimi apo refuzimi i ryshfetit. • Të vlerësojnë dhe të kultivojnë integritetin personal dhe etikën si parime udhëheqëse në jetën e tyre të përditshme.

<p>Nxënësit do të nxiten të propozojnë ide dhe nisma antikorrupsion në shkollë dhe komunitet, të identifikojnë organizatat e shoqërisë civile që punojnë kundër korrupsionit, të analizojnë dilema etike dhe të hartojnë plane veprimi për të promovuar transparencën dhe sjelljet etike.</p>	<p>shkolla mund të ndërmarrin për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar sjellje antikorrupsion.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë organizatat e shoqërisë civile që punojnë kundër korrupsionit dhe rolin e tyre në monitorim dhe avokim. • Të analizojë dilema etike që lidhen me korrupsionin dhe identifikojë zgjidhje etike, duke shpjeguar arsyetimin pas zgjedhjeve të tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të demonstrojnë qëndresë ndaj presionit të grupit apo mungesës së shpresës, duke mbetur të palëkundur në refuzimin e korrupsionit. • Të bëhen nismëtarë në propozimin dhe zbatimin e ideve që rrisin ndërgjegjësimin dhe promovojnë sjellje antikorrupsion në shkollë dhe komunitet. • Të jenë të hapur ndaj bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, duke kuptuar rolin e tyre në monitorim dhe avokim. • Të marrin vendime të bazuara në parime etike, duke shpjeguar arsyetimin e tyre. • Të hartojnë dhe të zbatojnë plane veprimi të thjeshta për të marrë
---	--	---

		<p>pjesë në iniciativa qytetare kundër korrupsionit ose për të promovuar transparencën.</p>
<p>Transparenca</p> <p>Ky mësim do të përqendrohet në konceptin e transparencës, duke i ndihmuar nxënësit ta përkufizojnë atë në kontekstin e qeverisjes dhe shërbimeve publike, si dhe ta dallojnë nga fshehtësia.</p> <p>Ata do të shpjegojnë rëndësinë thelbësore të transparencës në parandalimin e korrupsionit, duke ilustruar sesi mungesa e saj krijon hapësira për abuzim.</p> <p>Mësimi do të identifikojë, rendisë dhe trajtojë fusha jetike ku transparenca është e domosdoshme (p.sh., prokurimet publike, shpenzimet buxhetore), si dhe do të analizojë shembuj konkretë të mungesës së saj dhe pasojat negative që sjellin.</p> <p>Për më tepër, do të përshkruhen format e ndryshme të transparencës (proaktive dhe</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë konceptin e transparencës në kontekstin e qeverisjes dhe shërbimeve publike, duke e dalluar atë nga fshehtësia apo opaciteti. • Të shpjegojë pse transparenca është thelbësore për parandalimin e korrupsionit, duke ilustruar sesi mungesa e saj krijon hapësira për abuzim. • Të identifikojë dhe të listojë të paktën tre fusha ku transparenca është jetike (p.sh., prokurimet publike, shpenzimet buxhetore, proceset e vendimmarrjes, emërimet në poste publike). • Të analizojë shembuj konkretë të mungesës së transparencës (p.sh., tenderët me një ofertues, informacioni i klasifikuar pa arsye) dhe diskutojë pasojat negative që ato sjellin për shoqërinë. • Të përshkruajë format e ndryshme të transparencës, përfshirë transparencën proaktive 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritët të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin një qëndrim kërkues dhe aktiv ndaj transparencës së institucioneve publike, duke mos u mjaftuar me informacionin sipërfaqësor. • Të jenë të gatshëm të përdorin mjetet dhe platformat ekzistuese për të gjetur dhe analizuar informacionin publik, duke ushtruar të drejtën e tyre për informim. • Të përdorin dyshimin konstruktiv ndaj mungesës së transparencës dhe të jenë të

<p>reaktive) dhe do të tregohet sesi teknologjia (p.sh., portalet e të dhënave të hapura) mund ta rrisë atë.</p> <p>Nxënësit do të hulumtojnë raste studimore të suksesit të transparencës, do të zhvillojnë aftësi për të gjetur dhe analizuar informacionin publik, për të formuluar pyetje kritike ndaj institucioneve dhe për të promovuar rëndësinë e transparencës në mjedisin e tyre shoqëror.</p>	<p>(publikimi i informacionit nga institucionet) dhe atë reaktive (e drejta e qytetarëve për të kërkuar informacion).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregoj mënyra sesi teknologjia (p.sh., portalet e të dhënave të hapura, aplikacionet mobile) mund të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve. • Të hulumtojë dhe të prezantojë një rast studimor ku transparenca ka luajtur një rol kyç në luftën kundër korrupsionit ose në përmirësimin e qeverisjes. • Të gjejë dhe të analizojë informacionin publik (p.sh., buxhetet e bashkive, vendimet e këshillave bashkiakë) në platformat zyrtare të disponueshme. • Të formulojë pyetje kritike që një qytetar mund t'i drejtojë një institucioni publik për të kërkuar transparencë mbi një vendimmarrje apo shpenzim 	<p>gatshëm të pyesin dhe të kërkojnë llogaridhënie.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të bëhen avokatë të transparencës në mjedisin e tyre, duke inkurajuar shokët, familjarët dhe komunitetin të kërkojnë dhe të vlerësojnë informacionin publik. • Të përdorin teknologjinë në mënyrë të përgjegjshme për të rritur transparencën dhe për të monitoruar vendimmarrjen publike. • Të shërbejnë si shembull i një qytetari të informuar dhe aktiv, i cili kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më transparente dhe llogaridhënëse. • Të jenë të angazhuar jo vetëm në identifikimin e problemeve të transparencës, por edhe në
---	--	---

		propozimin dhe mbështetjen e zgjidhjeve konkrete.
TEMATIKA: TË DREJTAT E PUNËS		
6 orë		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime Sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>1. Kuptimi i kuadrit ligjor dhe specifikat e punësimit të të miturve</p> <p>Ky kapitull synon të ndërtojë njohuritë e nxënësve mbi kuadrin ligjor të punës në Shqipëri, duke theksuar rolin thelbësor të Kodit të Punës si rregullator i marrëdhënieve të punës.</p> <p>Fokusi kryesor do të jetë tek punësimi i të miturve; nxënësit do të mësojnë moshën minimale ligjore për punësim, kufizimet specifike që zbatohen për ta (si lloji i punës, orari dhe puna e natës), si dhe rëndësinë e pëlqimit të prindërve/kujdestarëve ligjorë dhe kontrolleve mjekësore.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e Kodit të Punës të Shqipërisë si rregullator kryesor i marrëdhënieve të punës. • Të identifikojë moshën minimale ligjore për punësim në Shqipëri dhe • Të shpjegojë kufizimet specifike (p.sh., lloji i punës, orari, puna e natës) që zbatohen për të miturit (16-18 vjeç) në punësim. • Të diskutojë për rëndësinë e pëlqimit të prindërve/kujdestarëve ligjorë dhe e kontrolleve mjekësore për punësimin e të miturve 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritët të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojë rëndësinë e kuadrit ligjor, konkretisht, të Kodit të Punës të Shqipërisë si rregullator kryesor i marrëdhënieve të punës dhe mbrojtës i të drejtave të punëtorëve. • Të jetë i vetëdijshëm për moshën minimale ligjore për punësim në Shqipëri dhe të kuptojë

<p>Kjo do t'i ndihmojë ata të kuptojnë mbrojtjen ligjore që u ofrohet të rinjve në tregun e punës.</p>		<p>kufizimet specifike që lidhen me të.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqë qëndrim mbrojtës ndaj të drejtave të të miturve në punësim, duke refuzuar dhe denoncuar punësimin e paligjshëm apo në kushte të dëmshme. • Të vlerësojë rëndësinë e masave mbrojtëse: rëndësinë e pëlqimit të prindërve/kujdestarëve ligjorë dhe të kontrolleve mjekësore si masa thelbësore mbrojtëse për sigurinë dhe shëndetin e të miturve në punësim. • Të jetë mbrojtës dhe nxitës i praktikave etike të punësimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për të rinjtë, duke nxitur zbatimin e plotë të ligjit.
--	--	--

<p>Të drejtat në punë si të drejta të njeriut</p> <p>Ky kapitull thëllon kuptimin e të drejtave të punës, duke i lidhur ato drejtpërdrejt me të drejtat themelore të njeriut. Nxënësit do të shpjegojnë sesi parime si paga e drejtë, orari i kufizuar, kushtet e sigurta të punës dhe mos diskriminimi janë zgjatime thelbësore të të drejtave për jetë, shëndet, dinjitet dhe një standard jetese të mjaftueshme</p> <p>Gjithashtu, ata do të analizojnë rëndësinë e lirisë së bashkimit në sindikata si një shprehje e lirive themelore të organizimit dhe shprehjes në kontekstin e punës.</p> <p>Në fund, kapitulli do të trajtojë dëmet e thella që shkaktojnë shkeljet e të drejtave të punës në dinjitetin njerëzor dhe në gëzimin e të drejtave themelore në përgjithësi, duke nxitur një ndërgjegjësim të plotë për rëndësinë e tyre.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë sesi parimet kryesore të të drejtave në punë (paga e drejtë, orari i kufizuar, kushtet e sigurta, mos diskriminimi) janë zgjatime të drejtpërdrejta të të drejtave themelore të njeriut (p.sh., e drejta për jetë, shëndet, dinjitet, standard jetese të mjaftueshme). • Të analizojë rëndësinë e lirisë së bashkimit në sindikata, si një shprehje e të drejtave të njeriut për lirinë e organizimit dhe lirinë e shprehjes në kontekstin e punës. • Të diskutojë për dëmet që shkaktojnë shkeljet e të drejtave të punës në dinjitetin njerëzor dhe në gëzimin e të drejtave themelore në përgjithësi 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritët të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të trajtojë dhe të mbrojë të drejtat themelore në punë si të drejta themelore të njeriut • Të vlerësojë dhe të mbështesë lirinë sindikale si një shprehje e të drejtave të njeriut për lirinë e organizimit dhe lirinë e shprehjes në kontekstin e punës. • Të nxisë diskutime për dëmet që shkaktojnë shkeljet e të drejtave të punës në dinjitetin njerëzor dhe në gëzimin e të drejtave themelore në përgjithësi.
<p>Njohja e disa prej të drejtave themelore të punëmarrësit</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritët të</p>

<p>Ky kapitull do të thellohet në elementet thelbësore të një marrëdhënieje pune të shëndetshme dhe ligjore.</p> <p>Nxënësit do të mësojnë të përkufizojnë dhe të kuptojnë rëndësinë e kontratës me shkrim, duke identifikuar pikat kyçe si paga, orari, pozicioni dhe pushimet.</p> <p>Ata do të njihen me të drejtat themelore të pagës (paga minimale, pagesa në kohë, fletëpagesa) dhe të pushimeve (ditore, javore, vjetore të paguara, festat zyrtare), si dhe do të përshkruajnë detyrimet e punëdhënësit për sigurinë dhe shëndetin në punë.</p> <p>Një pjesë e rëndësishme do t'i kushtohet dallimit dhe shpjegimit të formave të diskriminimit dhe ngacmimit, duke theksuar të drejtën për trajtim të barabartë dhe respekt.</p> <p>Në fund, kapitulli do të vlerësojë thellësisht rëndësinë e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë dhe të shpjegojë rëndësinë e kontratës me shkrim në marrëdhënien e punës, duke renditur elementet thelbësore që ajo duhet të përmbajë (p.sh., paga, orari, pozicioni, pushimet). • Të identifikojë dhe të shpjegojë të drejtat themelore të pagës (paga minimale, pagesa në kohë, fletëpagesa) dhe të pushimeve (pushimi ditor, javor, vjetor i paguar, festat zyrtare). • Të përshkruajë detyrimet e punëdhënësit lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe rëndësinë e tyre për çdo punëmarrës. • Të dallojë dhe të shpjegojë format e diskriminimit dhe e ngacmimit në punë, si dhe të drejtën për trajtim të barabartë dhe për respekt në vendin e punës. • Të vlerësojë rëndësinë e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të ardhmen e tyre (pension, shërbime shëndetësore). 	<p>demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojë rëndësinë e kontratës me shkrim të punës si veprimin e parë të domosdoshëm përpara fillimit të çdo pune. • Të lexojë me kujdes kontratën e punës për t'u siguruar që në të janë përfshirë të gjitha të drejtat e tij themelore. • Të kërkojë nga punëdhënësi dhe të sigurohet që ka përmbushur detyrimet për sigurinë dhe shëndetin në punë. • Të jetë vigjilent ndaj formave të diskriminimit dhe të ngacmimit në punë, dhe të përkushtohet për trajtim të barabartë dhe për respekt në vendin e punës, duke shfaqur një qëndrim refuzues ndaj këtyre fenomeneve.
---	---	--

<p>sigurinë financiare dhe shëndetësore afatgjatë të nxënësve.</p>		<ul style="list-style-type: none"> • Të verifikojë pagesën, nga ana e punëdhënësit, të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore
<p>Rreziqet e punësimit informal dhe roli i mbrojtjes</p> <p>Ky kapitull do të thellohet në sfidat dhe rreziqet e punësimit informal, duke ndërgjegjësuar nxënësit për pasojat negative që ai sjell si për individin (mungesa e mbrojtjes ligjore, shfrytëzimi, humbja e të drejtave) ashtu edhe për shoqërinë në tërësi. Ata do të mësojnë të identifikojnë institucionet kyçe, si Inspektorati i Punës dhe sindikatat, ku mund të kërkojnë ndihmë dhe këshilla ligjore në rast të shkeljes së të drejtave të punës. Për më tepër, kapitulli do të nxisë nxënësit të reflektojnë për rolin e tyre personal në refuzimin e punësimit informal dhe në promovimin aktiv të praktikave të ndershme dhe etike të punësimit.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë rreziqet dhe pasojat negative të punësimit informal ("në të zezë") si për punëmarrësin (mungesa e mbrojtjes ligjore, shfrytëzimi, pamundësia për të fituar të drejta) ashtu edhe për shoqërinë. • Të identifikojë institucionet kryesore tek të cilat mund të kërkohet ndihmë dhe këshilla ligjore në rast shkeljesh të të drejtave të punës (p.sh., Inspektorati i punës, sindikatat). • Të diskutojë rolin e tyre personal në refuzimin e punësimit informal dhe në promovimin e praktikave të ndershme të punësimit. 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritët të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jetë i vetëdijshëm për pasojat e punësimit informal dhe të luftojë për kundërshtojë të punojë “në të zezë”. • Të përdorë kanalet e denoncimit dhe ato tek të cilat mund të kërkojë ndihmë dhe këshilla ligjore në rast shkeljesh të të drejtave të punës (p.sh., Inspektorati i Punës, sindikatat). • Të angazhohet në promovimin e praktikave të ndershme të punësimit.

<p>Lidhja e të drejtave të punës me zgjedhjet e karrierës</p> <p>Ky kapitull i dedikohet ndërtimit të një karriere të suksesshme dhe të përgjegjshme, duke theksuar rëndësinë e njohurive ligjore në tregun e punës.</p> <p>Nxënësit do të mësojnë sesi njohja e Kodit të Punës dhe e të drejtave themelore ndikon në vendimmarrjen e tyre të informuar për zgjedhjen e një pune apo profesioni.</p> <p>Ata do të dallojnë mes punësimit formal dhe informal, duke analizuar rreziqet ligjore dhe ekonomike të këtij të fundit dhe duke theksuar rëndësinë e punësimit të ligjshëm për sigurinë dhe zhvillimin afatgjatë.</p> <p>Kapitulli gjithashtu do t'i pajisë nxënësit me aftësinë për të identifikuar kërkesat ligjore</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë sesi njohja e Kodit të Punës dhe e të drejtave themelore (paga minimale, orari, pushimet, siguria në punë) ndikon në vendimmarrjen e informuar për zgjedhjen e një pune apo karriere. • Të dallojë mes pozicioneve të punës që ofrojnë mbrojtje ligjore dhe atyre që nuk e bëjnë këtë, duke theksuar rëndësinë e punësimit formal për sigurinë dhe zhvillimin afatgjatë të karrierës. • Të analizojë rreziqet ligjore dhe ekonomike të punësimit informal (në të zezë) në kontekstin e ndërtimit të një karriere të qëndrueshme. • Të identifikojë kërkesat ligjore (p.sh., licencat, certifikimet, rregulloret specifike të sigurisë) që lidhen me profesione të caktuara që i interesojnë, duke kuptuar rëndësinë e tyre për ligjshmërinë dhe sigurinë në punë. • Të vlerësojë rolin e kontratave kolektive të punës dhe të sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve në sektorë ose profesione të 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi pritët të demonstrojë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shfaqin qëndrim pro aktiv dhe të informuar në vendimmarrjen për zgjedhjen e një pune ose karriere, duke u bazuar në njohuritë e Kodit të Punës dhe të drejtave themelore (paga minimale, orari, pushimet, siguria në punë). • Të kërkojë punët ose pozicionet e punës që garantojnë mbrojtje ligjore dhe atyre që nuk e bëjnë këtë, duke theksuar rëndësinë e punësimit formal për sigurinë dhe zhvillimin afatgjatë të karrierës së tyre.
--	---	--

<p>specifike për profesione të ndryshme, për të vlerësuar rolin e kontratave kolektive dhe sindikatave, si dhe për të kuptuar ndikimin e teknologjisë dhe globalizimit në tregun e punës.</p> <p>Në fund, ata do të zhvillojnë aftësi kritike për të shqyrtuar oferta pune, për të identifikuar problemet ligjore, për të ditur ku të drejtohen në rast shkeljesh, si dhe do të reflektojnë për rëndësinë e integritetit personal dhe etikës profesionale si themele të një karriere të suksesshme.</p>	<p>ndryshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të diskutojë sesi zhvillimet teknologjike dhe globalizimi po ndryshojnë tregun e punës dhe cilat aftësi ligjore (p.sh., kuptimi i kontratave digjitale, të drejtat në punën në distancë) do të jenë të rëndësishme për karrierat e tyre të ardhshme. • Të demonstrojë aftësinë për të shqyrtuar në mënyrë kritike një ofertë pune ose një draft-kontratë, duke identifikuar pikat kyçe ligjore dhe problemet e mundshme. • Të përcaktojnë hapat e duhur dhe institucionet (p.sh., inspektorati i Punës, sindikatat, avokatët) ku mund të drejtohen në rast shkeljesh të të drejtave të punës, duke treguar aftësi për zgjidhjen e problemeve. • Të reflektojë për rëndësinë e integritetit personal dhe etikës profesionale si themele të një karriere të suksesshme dhe të përgjegjshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të refuzojë punësimin informal në kërkim të ndërtimit të një karriere të qëndrueshme. • Të kërkojë njohjen me kërkesat ligjore që lidhen me profesione të caktuara që i interesojnë, duke kuptuar rëndësinë e tyre për ligjshmërinë dhe sigurinë në punë. • Të mbështesë veprimet që synojnë mbrojtjen kolektive të të drejtave të punëmarrësve. • Të ndjekin e të përditësohen me zhvillimet teknologjike dhe me ndryshimet në tregun e punës, për të qenë të gatshëm të përshtaten, duke kuptuar cilat aftësi ligjore (p.sh., kuptimi i kontratave digjitale, të drejtat në punën në distancë) do të jenë të
---	---	---

		<p>rëndësishme për karrierat e tyre të ardhshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jenë aktivë në shqyrtimin kritik të një ofertë pune ose të një draft-kontrate, duke identifikuar pikat kyçe ligjore dhe problemet e mundshme. • Të guxojnë të shfrytëzojnë mundësitë që ofrojnë institucionet si, Inspektorati i Punës, sindikatat, avokatët) për t'u drejtuar në rast shkeljesh të të drejtave të punës, duke treguar aftësi për zgjidhjen e problemeve. • Të tregojnë me vepra se si integriteti personal dhe etika profesionale janë të themele të një karriere të suksesshme dhe të përgjegjshme.
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> • Të propozojnë mënyra se si mund të mbrojnë të drejtat e tyre dhe të kolegëve në vendin e punës, duke promovuar një kulturë të respektit ligjor dhe etik.
<p>Mbrojtja e veçantë e fëmijëve nga shfrytëzimi në punë</p> <p>Kjo temë thekson cenueshmërinë e fëmijëve ndaj shfrytëzimit në punë, duke shpjeguar rolin thelbësor të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KKBF) në mbrojtjen e tyre.</p> <p>Nxënësit do të mësojnë të dallojnë qartë punën e lejuar nga ajo e paligjshme dhe e dëmshme për fëmijët, duke kuptuar se kjo e fundit përbën një shkelje të rëndë e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.</p> <p>Për më tepër, ata do të analizojnë sesi puna e fëmijëve cenon të drejtën për edukim dhe</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje të</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë fëmijët si një kategori veçanërisht e cenueshme ndaj shfrytëzimit në punë dhe të shpjegojë rolin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KKBF) në mbrojtjen e tyre. • Të dallojë punën e lejuar (nën kushte të rrepta dhe kufizime) nga puna e paligjshme dhe e dëmshme për fëmijët, duke theksuar se kjo e fundit është një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut dhe fëmijës. • Të analizojë sesi puna e fëmijëve cenon të drejtën e fëmijës për edukim dhe zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor dhe moral. 	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nga nxënësit pritet të demonstrojnë këto qëndrime dhe angazhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jenë vigjilentë dhe të identifikojnë raste të shfrytëzimit të fëmijëve në punë ose të përfshirjes së tyre në punë të paligjshme dhe të dëmshme e një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut dhe fëmijës. • Të angazhohen aktivisht në propozimin e mënyrave konkrete se si mund të kontribuojnë në ndërgjegjësimin

<p>zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor dhe moral.</p> <p>Në fund, kapitulli do të nxisë nxënësit të reflektojnë mbi përgjegjësinë e tyre individuale dhe kolektive në mbështetjen e praktikave të ndershme të punësimit dhe në luftën kundër shfrytëzimit.</p>		<p>e komunitetit për të drejtat në punë dhe për mbrojtjen e fëmijëve, duke marrë pjesë në fushata apo iniciativa që i shërbejnë një qëllimi të tillë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të reflektojnë për përgjegjësinë e tyre individuale dhe kolektive në mbështetjen e praktikave të ndershme të punësimit dhe në luftën kundër shfrytëzimit
--	--	--

TEMATIKA: TË DREJTAT E KONSUMATORIT

6 orë

Njohuri	Aftësi	Qëndrime Sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>Kuptimi i statusit të konsumatorit dhe kuadri ligjor. Të drejtat themelore të konsumatorit</p> <p>Kjo temë do të prezantojë nxënësit me konceptin e konsumatorit dhe rëndësinë</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë konceptin e konsumatorit dhe shpjegojë rëndësinë e mbrojtjes së tij në një ekonomi tregu. 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritët të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të demonstrojnë aftësinë për të vëzhguar e përzgjedhur shembuj

<p>thelbësore të mbrojtjes së tij në një ekonomi tregu.</p> <p>Ata do të njihen me Ligjin "Për mbrojtjen e konsumatorëve" si aktin kryesor ligjor në Shqipëri dhe do të mësojnë të renditin e të shpjegojnë të drejtat themelore të konsumatorit, si ajo për siguri, informacion, zgjedhje, dëgjim, kompensim/riparim dhe edukim. Përmes shembujve konkretë, nxënësit do të kuptojnë sesi këto të drejta zbatohen në blerjet e tyre të përditshme të produkteve dhe shërbimeve, duke i pajisur me njohuritë e nevojshme për të qenë konsumatorë të ndërgjegjshëm dhe të mbrojtur.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë Ligjin "Për mbrojtjen e konsumatorëve" si aktin kryesor ligjor që rregullon të drejtat e tyre në Shqipëri. • Të renditë dhe të shpjegojë të drejtat themelore të konsumatorit, duke përfshirë: të drejtën për siguri, të drejtën për informacion, të drejtën për zgjedhje, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për kompensim/riparim dhe të drejtën për edukim konsumator. • Të japë shembuj konkretë se si këto të drejta zbatohen në blerjet e përditshme të produkteve dhe shërbimeve. 	<p>konkretë se si këto të drejta zbatohen në blerjet e përditshme të produkteve dhe shërbimeve, duke treguar një kuptim praktik.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkushtohen si konsumatorë të mirinformuar, të gatshëm për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga praktikat e pandershme konsumatore.
<p>Lidhja e të drejtave të konsumatorit me të drejtat themelore të njeriut</p> <p>Kjo temë do të thellojë lidhjen midis të drejtave të konsumatorit dhe të drejtave themelore të njeriut.</p> <p>Nxënësit do të shpjegojnë sesi e drejta për siguri si konsumator është drejtpërdrejt e</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë sesi e drejta për siguri si konsumator lidhet drejtpërdrejt me të drejtën themelore të njeriut për jetë dhe shëndet. 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë sesi e drejta për siguri si konsumator lidhet drejtpërdrejt me të drejtën themelore të njeriut për jetë dhe

<p>lidhur me të drejtën për jetë dhe shëndet dhe do të analizojnë sesi e drejta për informacion dhe zgjedhje mbështesin lirinë e shprehjes dhe autonominë personale.</p> <p>Më tej, ata do të diskutojnë sesi e drejta për kompensim/riparim mbron të drejtën e pronës dhe garanton drejtësinë në marrëdhëniet tregtare.</p> <p>Në fund, tema do të mundësojë vlerësimin e ndikimit të praktikave tregtare tek e drejta për një standard jetese të mjaftueshme dhe e drejta për një mjedis të shëndetshëm, duke ndërgjegjësuar nxënësit për rolin e konsumatorit në një shoqëri të drejtë dhe të qëndrueshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë sesi e drejta për informacion dhe e drejta për zgjedhje si konsumator mbështesin lirinë e shprehjes dhe autonominë personale të individit. • Të diskutojë sesi e drejta për kompensim/riparim si konsumator mbron të drejtën e pronës dhe garanton drejtësinë në marrëdhëniet tregtare. • Të vlerësojë ndikimin e praktikave tregtare tek e drejta për një standard jetese të mjaftueshme dhe e drejta për një mjedis të shëndetshëm. 	<p>shëndet.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojnë sesi e drejta për informacion dhe e drejta për zgjedhje si konsumator mbështesin lirinë e shprehjes dhe autonominë personale të individit. • Të diskutojnë sesi e drejta për kompensim/riparim si konsumator mbron të drejtën e pronës dhe garanton drejtësinë në marrëdhëniet tregtare. • Të vlerësojnë ndikimin e praktikave tregtare tek e drejta për një standard jetese të mjaftueshme dhe e drejta për një mjedis të shëndetshëm.
<p>Identifikimi i praktikave të pandershme tregtare dhe rreziqet online</p> <p>Kjo temë trajton praktikat e pandershme tregtare dhe rreziqet e blerjeve, duke i pajisur</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jetë në gjendje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë dhe të analizojë praktikat e pandershme tregtare (p.sh., reklamimi mashtrues, praktikat 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritët të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p>

<p>nxënësit me njohuri thelbësore për të mbrojtur veten.</p> <p>Nxënësit do të mësojnë të dallojnë dhe analizojnë praktikat mashtruese si reklamimi i rremë, klauzolat abuzive apo produktet e falsifikuara, si dhe të identifikojnë rreziqet specifike të blerjeve online, përfshirë mashtrimet kibernetike dhe çështjet e privatësisë së të dhënave.</p> <p>Gjithashtu, përmes trajtimit të kësaj teme do të shpjegohet koncepti i të drejtës së tërheqjes për blerjet në distancë dhe do të udhëzojë nxënësit për hapat e duhur për të bërë një ankesë, duke filluar nga kontakti me biznesin deri te institucionet përkatëse.</p>	<p>agresive, klauzolat abuzive në kontrata, produktet e falsifikuara) dhe shpjegojnë ndikimin e tyre te konsumatorët.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë rreziqet specifike dhe format e mashtrimit që lidhen me blerjet online, duke përfshirë mashtrimet kibernetike dhe çështjet e privatësisë së të dhënave. • Të përshkruajë konceptin e të drejtës së tërheqjes (kthimit të produktit pa arsye) në blerjet në distancë dhe rëndësinë e saj. • Të përcaktojë hapat e duhur që duhet të ndjekë, në rastin e një ankesë, konsumatori, duke filluar nga kontakti me biznesin deri te institucionet përkatëse. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të monitorojnë dhe të identifikojnë praktikatat e pandershme tregtare (p.sh., reklamimi mashtrues, praktikatat agresive, klauzolat abuzive në kontrata, produktet e falsifikuara) • Të jenë të vëmendshëm, duke komunikuar edhe me të tjerë, për identifikimin e rreziqeve specifike dhe format e mashtrimit që lidhen me blerjet online, duke përfshirë mashtrimet kibernetike dhe çështjet e privatësisë së të dhënave. • Të angazhohen në ndërmarrjen e hapave të duhur që duhet të ndjekin, në rastin e një ankesë, duke filluar nga kontakti me
---	--	--

		biznesin deri te institucionet përkatëse.
<p>Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit</p> <p>Kjo temë finalizon njohuritë për mbrojtjen e konsumatorit, duke theksuar rolin e institucioneve dhe përgjegjësinë individuale. Nxënësit do të identifikojnë Autoritetin Kombëtar të Mbrojtjes së Konsumatorit (AKMK) si pikën kryesore të denoncimit për shkeljet e të drejtave të tyre.</p> <p>Mbi të gjitha, ata do të zhvillojnë një ndjenjë të fortë përgjegjësie si konsumatorë të mirinformuar, duke fituar aftësinë për të mbrojtur veten nga praktikat e pandershme tregtare.</p> <p>Në fund, nxënësit do t'i inkurajohen të propozojnë mënyra konkrete se si mund të kontribuojnë aktivisht në ndërgjegjësimin e të tjerëve për të drejtat e konsumatorit në komunitetin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë Autoritetin Kombëtar të Mbrojtjes së Konsumatorit (AKMK) si institucionin kryesor ku mund të denoncohen shkeljet e të drejtave të konsumatorit në Shqipëri. • Të zhvillojë një ndjenjë të përgjegjësisë si konsumator i mirinformuar dhe aftësinë për të mbrojtur veten nga praktikat e pandershme tregtare. • Të propozojë mënyra se si mund të kontribuojë në ndërgjegjësimin e të tjerëve për të drejtat e konsumatorit. 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritët të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të besojnë tek Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes së Konsumatorit (AKMK) si institucionin kryesor ku mund të denoncohen shkeljet e të drejtave të konsumatorit në Shqipëri dhe t'i drejtohen atij në raste shkeljesh. • Të demonstrojnë ndjenjën e përgjegjësisë si konsumator i mirinformuar dhe aftësinë për të mbrojtur veten nga praktikat e pandershme tregtare. • Të propozojnë mënyra se si mund të kontribuojnë në

		ndërgjegjësimin e të tjerëve për të drejtat e konsumatorit.
<p>Roli i qytetarit dhe mbrojtja për të drejtat e përbashkëta</p> <p>Ky kapitull përmbyll temën e të drejtave të konsumatorit duke nxitur nxënësit të reflektojnë për përgjegjësinë e tyre si qytetarë aktivë.</p> <p>Ata do të nxiten të mbështesin një treg të drejtë dhe etik që respekton të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, si dhe të propozojnë mënyra konkrete për të luftuar për rregulla më të mira të mbrojtjes së konsumatorit, veçanërisht për kategoritë e cenueshme. dhe përdorimi etik i teknologjisë (IA-së), duke krijuar një kuptim holistik dhe të thellë të rolit të ligjit në shoqëri.</p> <p>Mbrojtja e veçantë e fëmijëve si konsumatorë</p> <p>Një fokus i veçantë do t'i kushtohet fëmijëve si konsumatorë të cenueshëm; nxënësit do të</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të kësaj tematike, nxënësi duhet të jetë në gjendje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të reflektojë për përgjegjësinë e tij si qytetar për të mbështetur një treg të drejtë dhe etik që respekton të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve. • Të propozojë mënyra se si mund të luftojë për rregulla më të mira të mbrojtjes së konsumatorit, veçanërisht për kategoritë e cenueshme. • Të lidhë njohuritë e tij për të drejtën e konsumatorit me të tjera fusha të edukimit ligjor, si të drejtat e njeriut, ndërgjegjësimi kundër korrupsionit, dhe përdorimi etik i teknologjisë (IA-së), duke krijuar një kuptim holistik të rolit të ligjit në shoqëri. • Të identifikojë fëmijët si një kategori të cenueshme konsumatore dhe të shpjegojë pse u nevojitet mbrojtje ligjore e veçantë, duke iu referuar parimeve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të demonstrojnë përgjegjësinë e tyre si qytetarë për të mbështetur një treg të drejtë dhe etik që respekton të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve. • Të propozojnë mënyra se si mund të luftojnë për rregulla më të mira të mbrojtjes së konsumatorit, veçanërisht për kategoritë e cenueshme. • Të zbatojnë njohuritë e tyre për të drejtën e konsumatorit, të lidhura me fusha të tjera të edukimit ligjor, si të drejtat e njeriut, ndërgjegjësimi kundër korrupsionit, dhe përdorimi etik i

<p>shpjegojnë nevojën për mbrojtje ligjore të veçantë bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, do të analizojnë rregulloret e sigurisë së produkteve për fëmijë, do të vlerësojnë ndikimin e reklamave mashtruese dhe do të shpjegojnë rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë së të dhënave të fëmijëve online. Në fund, nxënësit do të nxiten të lidhin njohuritë e tyre për të drejtën e konsumatorit me fusha të tjera të edukimit ligjor, si të drejtat e njeriut, ndërgjegjësimi kundër korrupsionit dhe përdorimi etik i teknologjisë (IA-së), duke krijuar një kuptim holistik të rolit të ligjit në shoqëri.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë rregulloret e veçanta që lidhen me sigurinë e produkteve për fëmijë (p.sh., lodrat, ushqimet) dhe të shpjegojë pasojat e mosrespektimit të tyre për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve. • Të vlerësojë ndikimin e reklamave mashtruese ose agresive që u drejtohen fëmijëve dhe të diskutojë mjetet ligjore për t'i kufizuar ato. <p>Të shpjegojë rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë së të dhënave online të fëmijëve në kontekstin e të drejtave të konsumatorit</p>	<p>teknologjisë (IA-së), për të siguruar një zbatim më cilësor e të vetëdijshëm të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përditësojnë njohuritë e tyre në fushën e ligjit për mbrojtjen e fëmijëve si kategori të cenueshme konsumatore. • Të jenë të kujdesshëm në cilësinë e produkteve për fëmijë (edhe lodrat), përbërja e të cilave mund të jetë e rrezikshme për shëndetin e fëmijëve. • Të jenë aktivë në identifikimin e reklamave mashtruese ose agresive që u drejtohen fëmijëve dhe të diskutojnë mjetet ligjore për t'i kufizuar ato. • Të jenë të kujdesshëm kur bëhet fjalë për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave online të fëmijëve
--	--	--

		në kontekstin e të drejtave të konsumatorit.
TEMATIKA: SIGURIA NË RRUGË: KËMBËSOR, ÇIKLIST, MOTOÇIKLIST		
6 orë		
Njohuri	Aftësi	Qëndrime Sjellje të dëshiruara dhe të pritshme
<p>1. Zonat e përdorimit publik</p> <p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë e tyre për rregullat dhe elementet e rrugës si më poshtë: Përdoruesi i rrugës duhet të kuptojë rrugën si një hapësirë publike të destinuar për lëvizjen e këmbësorëve, mjeteve dhe kafshëve. Mësimdhënia do të fokusohet në dallimin e llojeve kryesore të rrugëve, duke përfshirë rrugët urbane, interurbane, autostradat dhe rrugët lokale, si dhe karakteristikat e veçanta të secilës.</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë saktësisht se çfarë është një rrugë dhe funksionin e saj kryesor si hapësirë publike e përbashkët. • Të dallojë llojet kryesore të rrugëve (urbane, interurbane, autostrada, lokale) duke shpjeguar karakteristikat e secilës. • Të identifikojë dhe të shpjegojë funksionin e elementeve kryesore të rrugës, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Karrexhatën: si hapësira kryesore për qarkullimin e mjeteve. ○ Trotuarin: si hapësira e destinuar për 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritjet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojnë rrugën si hapësirë publike. • Të mbrojnë sigurinë e vetes dhe të tjerëve. • Të sillen në varësi të vendndodhjes në hapësirën publike.

<p>Njohja e elementeve themelore të rrugës është thelbësore për një qarkullim të sigurt. Nxënësi do të mësojë të identifikojë dhe të përshkruajë funksionin e:</p> <p>Karrexhatës: si hapësira kryesore për automjetet.</p> <p>Trotuarit: si hapësira e destinuar vetëm për këmbësorët.</p> <p>Bankinës: si pjesa anësore e rrugës për siguri dhe ndihmë, në të cilën duhet të qarkullojnë këmbësorë dhe kafshët kur nuk ka trotuar.</p> <p>Korsisë: si ndarja e karrexhatës.</p> <p>Për të menaxhuar në mënyrë të sigurt ndërveprimin me përdoruesit e tjerë, nxënësi do të shpjegojë rëndësinë e kryqëzimeve dhe degëzimeve. Mësimi do të theksojë qarkullimin e lejuar dhe të ndaluar të këmbësorëve, mjeteve dhe kafshëve në elementet e ndryshme të rrugës, duke theksuar që rruga është një sistem me rregulla të qarta.</p>	<p>këmbësorët.</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Bankinën: si pjesë anësore e rrugës për siguri dhe ndihmë. ○ Korsinë: si një nga ndarjet e karrexhatës. <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë rëndësinë e kryqëzimeve dhe degëzimeve si pika kyçe në rrjetin rrugor, duke listuar llojet kryesore të kryqëzimeve. • Të renditë me saktësi se cilat janë elementet e rrugës ku lejohet dhe nuk lejohet të qarkullojnë këmbësorët, mjetet dhe kafshët 	
--	---	--

<p>2. Qendra e Banuar</p> <p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë e tyre për qendrat e banuara dhe rregullat e qarkullimit si më poshtë.</p> <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje të përkufizojë saktësisht një qendër të banuar dhe ta dallojë atë nga një zonë interurbane. Kjo do të theksojë rëndësinë e një qarkullimi më të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm në mjedise të populluara, ku shpejtësia është më e vogël dhe rreziku më i lartë.</p> <p>Nxënësi do të mësojë të identifikojë dhe të përshkruajë elementet themelore të një qendre të banuar. Këto përfshijnë banesat, rrugët, trotualet, sheshet, pedonalet, shkollat, institucionet social-kulturore dhe parkimet. Përmes kësaj njohurie, ai do të kuptojë ndërvarësinë mes tyre dhe rëndësinë e bashkëjetesës.</p> <p>Mësimdhënia do të fokusohet në rregullat e</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë çfarë është një qendër e banuar dhe të shpjegojnë ndryshimin mes saj dhe zonave interurbane. • Të identifikojë dhe të përshkruajë elementet kryesore të një qendre të banuar si: <ul style="list-style-type: none"> ○ Banesat dhe rrugët. ○ Trotualet dhe sheshet. ○ Pedonalet, sheshet, rrugët, zonat për këmbësorë ○ Shkollat, institucionet social-kulturore dhe parkimet. • Të shpjegojë ndërvarësinë mes këtyre elementeve dhe rëndësinë e tyre për një qarkullim të sigurt dhe funksional. • Të analizojë rregullat e qarkullimit brenda një qendre të banuar, duke theksuar rëndësinë e kujdesit të shtuar për shkak të numrit të madh të këmbësorëve dhe mjeteve. 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritët të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të sillen në varësi të vendndodhjes në hapësirën publike. • Të vlerësojnë kryqëzimet si zona me rrezik të lartë dhe sillen në përputhje me këtë. • Të pranojnë që qendra e banuar është një ekosistem i gjallë ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe lëvizin. • Të tregojë kujdes të shtuar në zonat urbane . • Të pranojnë që elementet e hapësirave të përbashkëta i shërbejnë një qëllimi të caktuar dhe duhen respektuar. • Të përshtatin sjelljen në varësi të veçorive të zonës.
---	--	---

<p>qarkullimit brenda qendrës së banuar, duke theksuar nevojën për kujdes të shtuar për shkak të pranisë së lartë të këmbësorëve dhe mjeteve. Një pjesë e rëndësishme e këtij mësimi është analizimi i rrezikut dhe përshtatja e sjelljes për një mjedis urban të sigurt.</p>		
<p>3. Sinjalet rrugore dhe kuptimi i tyre Kjo temë synon të pajisë nxënësit me njohuri thelbësore mbi sinjalistikën rrugore. Në përfundim të kësaj teme, ata do të jenë të aftë të identifikojnë dhe shpjegojnë kuptimin e sinjaleve kryesore rrugore, duke përfshirë ato të ndalimit, përparësisë, rrezikut dhe kufizimit të shpejtësisë, si dhe llojet e sinjaleve (vertikale, horizontale, të shndritshme, të policit të trafikut) Për më tepër, nxënësit do të zhvillojnë aftësinë për të analizuar situata të thjeshta trafiku, duke kuptuar se si sinjalet drejojnë lëvizjen dhe kontribuojnë në sigurinë rrugore.</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkufizojë sinjalistikën rrugore si një sistem komunikimi që transmeton rregulla, paralajmërime dhe informacione • Të identifikojë llojet kryesore të sinjaleve rrugore dhe mesazhet që secili prej tyre transmeton. • Të identifikojë sinjalet kryesore rrugore (p.sh., ndalo, jep përparësi, rrezik, shpejtësia maksimale). • Të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e secilit sinjal në garantimin e sigurisë rrugore. • Të vlerësojë rëndësinë e njohjes dhe respektimit të sinjaleve rrugore për parandalimin e aksidenteve. • Të dallojë dhe të shpjegojë tre elementet bazë të një 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të trajtojnë sinjalet rrugore si pjesë thelbësore e mjedisit dhe si mekanizma për të rregulluar bashkëpunimin mes përdoruesve të rrugës • Të shfaqin një ndjenjë përgjegjshmërie ndaj rregullave të trafikut dhe sigurisë rrugore. • Të marrin e të pranojnë përgjegjësinë e tyre për mosrespektimin e rregullave.

<p>Mbi të gjitha, ata do të vlerësojnë rëndësinë kritike të njohjes dhe respektimit të këtyre sinjaleve si një mjet kyç për parandalimin e aksidenteve dhe garantimin e një mjedisi rrugor më të sigurt për të gjithë.</p>	<p>sinjali vertikal: fusha, konturi dhe simboli.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të klasifikojë dhe të interpretojë kategoritë kryesore të sinjaleve vertikale: <ul style="list-style-type: none"> ○ Sinjalet e rrezikut: Përshkruajnë rreziqe potenciale dhe kërkojnë kujdes të shtuar. ○ Sinjalet urdhëruese: Tregojnë rregulla dhe detyrime që duhet të ndiqen. ○ Sinjalet treguese: Ofron informacion për drejtimet, destinacionet dhe shërbimet. • Të klasifikojë sinjalet vertikale sipas funksionit (p.sh., sinjale rreziku, ndalimi, detyrimi, informacioni). • Të interpretojë kuptimin e shenjave horizontale si vijat ndarëse të korsive, vijat e ndalimit, apo vendkalimet e këmbësorëve. • Të demonstrojë kuptimin e ndërveprimit mes sinjaleve vertikale dhe horizontale në situata të ndryshme rrugore • Të analizojë situata të thjeshta trafiku dhe të tregojë se si sinjalet ndihmojnë në drejtimin e lëvizjes. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të jenë të vëmendshëm ndaj sinjaleve rrugore në çdo situatë trafiku, duke i konsideruar ato si udhëzues thelbësorë. • Të jenë kritikë ndaj sjelljeve të pasigurta në rrugë, si të tyre ashtu edhe të të tjerëve. • Të respektojnë pa diskutim hierarkinë e sinjaleve rrugore dhe udhëzimet e policit të trafikut. • Të jenë të aftë të përshtatin sjelljen e tyre në varësi të llojit të sinjalit dhe kushteve të trafikut. • Të zhvillojnë një qëndrim parashikues ndaj situatave të mundshme rrugore bazuar në sinjalistikën e pranishme. • Të zbatojë rregullat e lëvizjes në kryqëzime të rregulluara nga semafori ose nga polici i trafikut.
--	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë sinjalet e shndritshme (semaforët) dhe rendin e dritave (e gjelbër, e verdhë, e kuqe). • Të shpjegojë kuptimin e secilës ngjyrë të semaforit dhe veprimet që duhen ndërmarrë. • Të përshkruajë sinjalet me dorë të policit të trafikut dhe rëndësinë e tyre si përparësi ndaj sinjaleve të tjera. • Të krahasojë dhe zbatojë hierarkinë e sinjaleve (polici > semafori > sinjalet vertikale/horizontale). 	
<p>4. Sjella e sigurt e këmbësorëve në trafik</p> <p>Ky grupim i objektivave mësimore përqendrohet në rregullat dhe sjelljen e sigurt të këmbësorëve në trafik.</p> <p>Nxënësit do të mësojnë të përshkruajnë rregullat e qarkullimit në trotuare dhe në rrugë, si dhe të identifikojnë zonat e sigurta dhe të rrezikshme.</p> <p>Ata do të zhvillojnë aftësinë për të zbatuar rregullat e kalimit të sigurt të rrugës, veçanërisht në vendkalimet e këmbësorëve</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë vendet e sigurta për të kaluar rrugën, si vijat e bardha (zebra) dhe kalimet nëntokësore/mbitokësore, si dhe ato të pasigurta. • Të përshkruajë mënyrën e duhur të lëvizjes kur janë në trotuar, duke theksuar ecjen në anën e duhur dhe ndërgjegjësimin për pengesat. • Të ndalojë e të analizojë rregullat e ecjes në bankinë kur nuk ka trotuar, duke kuptuar rëndësinë e ecjes kundër-drejtimit të trafikut për të parë mjetet 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritët të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojnë kujdes maksimal gjatë qarkullimit dhe kalimit të rrugës, duke vënë sigurinë personale dhe të tjerëve në plan të parë. • Të shërbejnë si shembull pozitiv për këmbësorët e tjerë, veçanërisht për fëmijët dhe të

<p>dhe në kryqëzime, duke përfshirë njohjen e sinjaleve specifike për këmbësorët dhe rregullat e përparësisë.</p> <p>Gjithashtu, objektivat përfshijnë njohjen e rregullave të sigurisë dhe sjelljes së duhur gjatë përdorimit të mjeteve të transportit publik, duke theksuar rëndësinë e respektimit të tyre për sigurinë personale dhe të përgjithshme.</p>	<p>që vijnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë dhe të përshkruajë dallimet në sjellje kur ecet në grup (ditën dhe natën), duke shpjeguar përdorimin e elementeve reflektuese dhe ecjen në një rresht. • Të renditë masat shtesë të sigurisë kur lëvizin në rrugë gjatë motit të keq (shi, dëborë, akull) dhe natën, duke theksuar dukshmërinë e ulët. • Të shpjegojë parimin bazë të lëvizjes së këmbësorit kur ndeshet me mjetet rrugore, duke theksuar rëndësinë e ndërveprimit me drejtuesit e mjeteve. • Të shpjegojë rëndësinë e kontaktit me sy me drejtuesit e mjeteve • Të identifikojë vendet e sigurta për të pritur dhe hipur në mjetet e transportit publik. • Të demonstrojnë aftësinë për të vlerësuar shpejtësinë dhe distancën e automjeteve përpara se të kalojë rrugën 	<p>moshuarit, duke zbatuar rregullat.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jenë të ndërgjegjshëm për rreziqet dhe të shmangin sjelljet shpërqendruese (p.sh., përdorimi i telefonit) gjatë ecjes në rrugë. • Të vlerësojë rëndësinë e respektimit të rregullave për sigurinë personale dhe të pasagjerëve të tjerë e t'i vërë ato në zbatim. • Të analizojnë situata komplekse në kryqëzime dhe të marrë vendime të sigurta për kalim. • Të zbatojnë rregullat e përparësisë për këmbësorët në kryqëzime të rregulluara dhe të parregulluara. • Të respektojnë urdhrat e një policia rrugor kur ai është në kryqëzim.
--	---	---

<p>5. Kalimi i rrugës dhe i kryqëzimeve</p> <p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë e tyre për kalimin e sigurt të rrugës dhe kryqëzimeve, duke përfshirë sa vijon:</p> <p>Nxënësi do të mësojë procedurën e saktë për të kaluar një kryqëzim pa sinjalistikë. Kjo përfshin vlerësimin e trafikut që vjen dhe kuptimin e rëndësisë së kujdesit shtesë në këto pika të ndërveprimit rrugor.</p> <p>Mësimi do të fokusohet në rregullat për kalimin e rrugës në vendkalimet e vizuara për këmbësorët. Nxënësi do të kuptojë se edhe pse ka përparësi, ai duhet të jetë gjithmonë i kujdesshëm. Po ashtu, do të shpjegohet mënyra e saktë për të kaluar një kryqëzim me semafor, duke u bazuar në dritën e caktuar për këmbësorët dhe duke shmangur kalimin me dritë të kuqe.</p> <p>Një pjesë kyçe e kësaj teme është hierarkia e sinjaleve. Nxënësi do të interpretojë dhe</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë procedurën e saktë për të kaluar një kryqëzim pa sinjale rrugore, duke u ndalur te rëndësia e vlerësimit të trafikut që vjen. • Të shpjegojë rregullat për të kaluar rrugën në vendkalimet e vizuara për këmbësorët (vijat e bardha), duke kuptuar se këmbësori ka përparësi, por duhet të jetë gjithnjë i kujdesshëm. • Të interpretojë dhe të respektojë urdhrat e një polici rrugor kur ai është në kryqëzim, duke theksuar se këto sinjale janë mbi çdo lloj tjetër sinjalistike (semafori, sinjali vertikal). • Të përshkruajë mënyrën e saktë për të kaluar një kryqëzim me semafor, duke u bazuar në dritën e semaforit për këmbësorët dhe atë për mjetet, si dhe duke shmangur kalimin me dritë të kuqe. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme: • Të jenë të vëmendshëm ndaj mjedisit rrugor. • Të shmangin shpërqendrimet si telefoni celular, kufjet apo bisedat e thella, sidomos kur i afrohet një rruge ose kryqëzimi. • Të pranojnë që përparësia e tyre në vijat e bardha nuk është e mjaftueshme për të shmangur rrezikun. •
---	---	--

<p>respektojë urdhrat e një polici të trafikut në një kryqëzim, duke theksuar se sinjalet e tij janë mbi çdo lloj tjetër sinjali (si semaforët apo tabelat vertikale), duke garantuar një qarkullim të sigurt dhe efikas.</p>		
<p>6. Rregullat e pasagjerit</p> <p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë e tyre për rregullat dhe masat e sigurisë që duhet të zbatohen nga pasagjerët, duke përfshirë:</p> <p>Nxënësi do të mësojë rregullat themelore të sigurisë për hipjen dhe zbritjen nga automjetet, duke theksuar se dera duhet hapur gjithmonë me kujdes dhe nga ana e trotuarit. Për më tepër, ata do të analizojnë rregullat e qëndrimit në stacionet e autobusit, duke përfshirë rëndësinë e respektimit të radhës dhe kujdesin gjatë hipjes e zbritjes. Një fokus i rëndësishëm i këtij mësimi është siguria e brendshme. Nxënësit do të mësojnë mbi mënyrën e duhur të qëndrimit dhe</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë rregullat e sigurisë për hipjen dhe zbritjen nga një autoveturë, duke theksuar rëndësinë e hapjes së derës me kujdes dhe nga ana e trotuarit. • Të përshkruajë mënyrën e duhur të qëndrimit brenda autoveturës dhe të kuptojnë rëndësinë jetike të përdorimit të rripit të sigurisë për veten dhe pasagjerët e tjerë. • Të analizojë rregullat e qëndrimit në stacionet e autobusit, duke përfshirë qëndrimin në vendin e caktuar, respektimin e radhës dhe kujdesin gjatë hipjes e zbritjes. • Të identifikojë dhe të shpjegojë masat e sigurisë për pasagjerët në motor, duke theksuar përdorimin 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritjet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojë që veprimet e tij si pasagjer ndikojnë tek të tjerët. • Të përdorin rripin e sigurimit si përparësi absolute dhe jo si detyrim. • Të mbrojnë veten si pasagjer i një motori duke vendosur kaskën mbrojtëse. • Të tregojë kujdes për qëndrimin e tij në stacionin e autobusit.

<p>rëndësinë jetike të përdorimit të rripit të sigurisë, si për veten ashtu edhe për pasagjerët e tjerë. Për pasagjerët në motor, do të theksohet përdorimi i detyrueshëm i kaskës mbrojtëse dhe veshjeve të përshtatshme, si masa thelbësore të sigurisë</p>	<p>e detyrueshëm të kaskës mbrojtëse dhe veshjeve të përshtatshme.</p>	
<p>7. Sjellja në rrugë gjatë situatave të veçanta</p> <p>Gjatë trajtimit të kësaj teme, nxënësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë dhe qëndrimet e duhura për të vepruar në situata të veçanta në trafik, duke përfshirë:</p> <p>Reagimi ndaj mjeteve të emergjencës</p> <p>Nxënësi do të kuptojë rëndësinë jetike të dhënies së përparësisë dhe hapësirës për mjetet e emergjencës (si ambulanca, zjarrfikësja dhe policia) kur ato përdorin sinjalet e tyre. Ata do të mësojnë se si të reagojnë në mënyrë të sigurt dhe të shpejtë për të lehtësuar kalimin e këtyre automjeteve.</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë rëndësinë e dhënies së përparësisë dhe hapësirës për mjetet e emergjencës (zjarrfikësja, ambulanca, policia) kur ato përdorin sinjale dritore dhe zanore. • Të përshkruajë sjelljen e duhur të drejtuesve dhe pasagjerëve kur ndeshen me kolona ushtarake ose mortore, duke theksuar respektin dhe shmangien e ndërprerjes së kolonës. • Të analizojë rregullat e qarkullimit kur ndeshen me kolona nxënësish të shkollave, duke u dhënë përparësi dhe duke ngarë me shpejtësi të reduktuar. • Të demonstrojë ndërgjegjësim të lartë dhe sjellje të përgjegjshme si pasagjerë në automjete të ndryshme 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të pranojnë dhënien e përparësisë, jo vetëm si rregull, por edhe një detyrim moral. • Të mbajë qëndrim vigjilent ndaj sinjaleve zanore që lidhen me mjetet e emergjencës edhe përpara se të shohë mjetet. • Të tregojë respekt ndaj kolonave ushtarake ose mortore • Të tregojë kujdes dhe mbrojtje ndaj grupeve më të dobët

<p>Mësimi do të theksojë rëndësinë e respektit ndaj kolonave ushtarake ose mortore.</p> <p>Nxënësi do të mësojë sjelljen e duhur, si dhe të shmangë ndërprerjen e tyre. Përveç kësaj, do të analizohen rregullat e qarkullimit kur ndeshen me kolona nxënësish, duke theksuar nevojën për të dhënë përparësi dhe për të ulur shpejtësinë.</p> <p>Në fund, nxënësi do të demonstrojë një ndërgjegjësim të lartë social dhe sjellje të përgjegjshme si pasagjer në situata të ndryshme dhe të paparashikuara, duke vërtetuar se siguria në rrugë është një përgjegjësi e përbashkët.</p>	<p>dhe në situata të paparashikuara në trafik.</p>	<p>((kolonat e shoqëruara të nxënësve, të moshuar etj)</p>
<p>8. Ndhim në raste emergjence</p> <p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për të vepruar në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme në rast aksidenti rrugor, duke përfshirë sa vijon:</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë si duhet të veprohet në rast të një aksidenti rrugor, duke filluar me vlerësimin e sigurisë së zonës. • Të renditë me saktësi numrat e urgjencës dhe procedurën e lajmërimit të policisë rrugore, të 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të sigurohen që nuk vendosin veten në rrezik gjatë kohës që

<p>Nxënësi do të mësojë si të veprojë në rastin e një aksidenti rrugor. Kjo përfshin hapin e parë dhe më thelbësor: vlerësimin e sigurisë së zonës për të garantuar që as ai vetë dhe as të tjerët nuk janë në rrezik. Ata do të demonstrojnë një ndërgjegjësimit të lartë social dhe një gatishmëri për të ndihmuar, duke treguar empati dhe përgjegjshmëri.</p> <p>Mësimi do të fokusohet në procedurën e saktë të lajmërimit të urgjencave. Nxënësi do të rendisë me saktësi numrat e shërbimeve si policia rrugore, ambulanca dhe zjarrfikësja. Për më tepër, do të shpjegohet informacioni thelbësor që duhet dhënë gjatë raportimit të një aksidenti, duke përfshirë vendndodhjen e saktë, shkallën e dëmtimit dhe numrin e personave të përfshirë. Kjo siguron që ndihma të mbërrijë sa më shpejt dhe në mënyrë sa më efektive.</p>	<p>ambulancës dhe të zjarrfikësve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë informacionin thelbësor që duhet të jepet në telefon kur raportohet një aksident: vendndodhja e saktë, shkalla e dëmtimit, numri i personave të përfshirë dhe numri i tyre i telefonit. • Të demonstrojnë një ndërgjegjësimit të lartë social dhe një gatishmëri për të ndihmuar në situata emergjente në rrugë, duke shfaqur empati dhe përgjegjshmëri. 	<p>ofrojnë ndihmën e tyre.</p> <p>Prioriteti i sigurisë personale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dëshmojnë gatishmërinë për të ndihmuar dhe ndjenjë të fortë empatie. • Të bëjnë kujdes që informacioni që ofrojnë të jetë i qartë, i shkurtër dhe i saktë. • Të mbajnë mend të gjitha numrat e emergjencave
--	---	--

<p>9. Sjella e sigurt e çiklistëve në trafik</p> <p>Kjo temë synon të pajisë nxënësit me njohuritë dhe aftësitë thelbësore që duhet të zotërojnë si çiklistë.</p> <p>Ata do të mësojnë të përshkruajnë rregullat e qarkullimit të biçikletave dhe rëndësinë e pozicionimit të duhur në karrexhatë, si dhe të identifikojnë rreziqet e zakonshme.</p> <p>Objektivat përfshijnë gjithashtu zbatimin e procedurave të sigurta për kthesat dhe ndryshimin e drejtimit, njohjen e rregullave të përparësisë në kryqëzime, dhe vlerësimin e shpejtësisë së përshatshme dhe distancës së sigurisë.</p> <p>Në fund, nxënësit do të jenë në gjendje të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e parakalimit të sigurt, duke kontribuar në një pjesëmarrje më të sigurt dhe më të përgjegjshme në trafik.</p> <p>Përveç kësaj, nxënësi do të mësojë edhe për rëndësinë e pajisjeve mbrojtëse, për rëndësinë</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë kontrollet kryesore që duhet të kryhen para çdo udhëtimi me biçikletë (p.sh., gomat, frenat, timoni, dritat), duke theksuar rëndësinë e mirëmbajtjes për sigurinë. • Të përshkruajë mënyrën e saktë të nisjes me biçikletë, duke theksuar rëndësinë e sinjalizimit dhe ndërgjegjësimit për mjetet e tjera. • Të përshkruajë si të lëvizin në mënyrë të sigurt me biçikletë në rrugë të drejtë, në kthesa, dhe në kryqëzime (me dhe pa semafor). • Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes së një distance sigurie nga mjetet e tjera, si para dhe anash, për të parandaluar përplasjet dhe për të pasur kohë për të reaguar. • Të analizojnë rregullat e qarkullimit kur jeni në grup me biçikletë (p.sh., lëvizja në një kolonë, sinjalizimi i njëkohshëm). • Të identifikojë masat e sigurisë shtesë për qarkullimin gjatë natës dhe në mot të keq, si 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritet të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojnë rëndësinë e pajisjeve mbrojtëse (kaskë, veshje reflektuese) dhe t'i përdorin ato vazhdimisht. • Të sigurojnë dukshmërinë e tyre në rrugë, veçanërisht në kushte të vështira. • Të shfaqin një qëndrim bashkëpunues me përdoruesit e tjerë të rrugës, duke ndarë hapësirën në mënyrë të sigurt. • Të zbatojnë rregullat e kalimit në kryqëzime, duke i dhënë përparësi mjeteve dhe këmbësorëve kur është e nevojshme.
---	---	---

<p>e mirëmbajtjes së biçikletës, të kontrollit të saj të shpeshtë si dhe të veshjeve të duhura për t’u bërë sa më i dukshëm në rrugë.</p>	<p>përdorimi i dritave, reflektorëve dhe veshjeve të dukshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë rëndësinë e qëndrimit të duhur në karrexhatë për sigurinë e çiklistit. • Të identifikojë rreziqet e zakonshme gjatë qarkullimit me biçikletë. • Të zbatojë procedurat e duhura për marrjen e kthesave dhe ndryshimin e drejtimit, duke përfshirë sinjalizimin me dorë. • Të demonstrojë aftësinë për të vlerësuar hapësirën dhe kohën e nevojshme për manovra të sigurta. • Të përshkruajë rregullat e përparësisë për çiklistët në kryqëzime të rregulluara dhe të parregulluara. • Të analizojë situata të ndryshme në kryqëzime dhe të marrë vendime të sigurta. • Të shpjegojë konceptin e shpejtësisë së përshtatshme dhe të distancës së sigurisë për çiklistët. • Të vlerësojë faktorët që ndikojnë në shpejtësinë dhe distancën e sigurisë (p.sh., kushtet e motit, trafiku). 	
---	---	--

	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë rregullat për parakalimin e mjeteve të tjera dhe për t'u parakaluar nga to • Të zbatojë parimet e parakalimit të sigurt, duke ruajtur distancën e nevojshme dhe duke sinjalizuar. • Të shpjegojë si të kalojnë me kujdes vendkalimet e këmbësorëve, duke dhënë gjithmonë përparësi për këmbësorët, sidomos për të miturit dhe të moshuarit. • Të përshkruajë mënyrën e duhur të ndalimit, sigurimit dhe parkimit të biçikletës, duke theksuar se biçikleta nuk duhet të pengojë lëvizjen e këmbësorëve apo mjeteve të tjera. 	
<p>10. Rregullat e sjelljes në rrugë të skuterëve elektrikë</p> <p>Rregullat e qarkullimit rrugor</p> <p>Kjo temë synon të pajisë nxënësit me njohuritë dhe aftësitë thelbësore që duhet të zotërojnë si përdorues të skuterit elektrik.</p> <p>Ata do të mësojnë të përshkruajnë rregullat e qarkullimit të skuterit elektrik dhe rëndësinë e</p>	<p>Pas trajtimit të kësaj teme, nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë dhe të shpjegojë rregullat kryesore të qarkullimit rrugor që vlejné për skuterët (p.sh., shenjat e rrugës, semaforët, rregullat e parakalimit, etj.). • të renditë dhe të shpjegojë rëndësinë e të gjitha pajisjeve mbrojtëse të detyrueshme dhe të rekomanduara (p.sh., kasketa, dorezat, veshjet 	<p>Pas zhvillimit të kësaj tematike nga nxënësit pritët të demonstrojnë qëndrimet e mëposhtme</p> <ul style="list-style-type: none"> • të pozicionohen saktë në korsi, duke ruajtur një distancë të sigurt nga automjetet e tjera dhe duke shmangur "zonat e verbëra" të shoferëve të makinave. • të pranojnë se drejtimi i skuterit është një përgjegjësi e madhe dhe

<p>pozicionimit të duhur në karrexhatë, si dhe të identifikojnë rreziqet e zakonshme.</p> <p>Objektivat përfshijnë gjithashtu zbatimin e procedurave të sigurta për kthesat dhe ndryshimin e drejtimit, njohjen e rregullave të përparësisë në kryqëzime, dhe vlerësimin e shpejtësisë së përshtatshme dhe distancës së sigurisë.</p> <p>Në fund, nxënësit do të jenë në gjendje të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e parakalimit të sigurt, duke kontribuar në një pjesëmarrje më të sigurt dhe më të përgjegjshme në trafik.</p> <p>Përveç kësaj, nxënësi do të mësojë edhe për rëndësinë e pajisjeve mbrojtëse, për rëndësinë e mirëmbajtjes së skuterit, të kontrollit të tij të shpeshtë si dhe të veshjeve të duhura për t'u bërë sa më i dukshëm në rrugë.</p>	<p>mbrojtëse, këpucët e përshtatshme) dhe të kuptojë se pse përdorimi i tyre është i domosdoshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë pikat kryesore të kontrollit të skuterit para se të nisët (p.sh., presioni i gomave, funksionimi i frenave, dritat, niveli i karburantit) dhe të kuptojë rëndësinë e mirëmbajtjes së rregullt. • të demonstrojë aftësi themelore të domosdoshme për t'u ditur dhe zbatuar në kontrollin e skuterit, duke përfshirë nisjen, ndalimin, manovrimin në shpejtësi të ulët, dhe kthesat e sigurta. • të renditë rreziqet e mundshme në rrugë (p.sh., gropa, rrëshqitje, ndryshime të papritura të rrugës, veprime të pasigurta të shoferëve të tjerë) dhe të tregojë disa nga masat parandaluese të rreziqeve që lidhe me to. 	<p>se duhet të jetë gjithmonë i vëmendshëm, i durueshëm dhe të shmangë rreziqet e panevojshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • të pranojnë dhe të zbatojnë rregullin e mos drejtimit të skuterit nën ndikimin e alkoolit ose drogave, dhe të shmangë përdorimin e telefonit celular gjatë drejtimit. • të shfaqin respekt për pjesëmarrësit e tjerë në trafik, duke përfshirë këmbësorët, çiklistët dhe shoferët e tjerë, dhe të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi rrugor më të sigurt për të gjithë.
---	--	--

4 UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përmbajtja e lëndës së qytetarisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit;
- larmi strategjish dhe teknikash të përshtatura për moshën (skenarë, lojëra me role, diskutime, të ftuar, përdorim mjetes artistike etj.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimit dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimit dhe të të nxënësve, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dalë nga nxënësit, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufijve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, këndvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst lënda e qytetarisë ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të përmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të nxënësve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruari reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimdhëniet e tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-nxënës, mjedis fizik, materiale didaktike, personale të mësuesit dhe nxënësit, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë fëmijët, nxënësit, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

5 ÇFARË KËRKOHEM NGA MËSUESI I LËNDËS SË QYTETARISË?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- dijet e integruara ndër lëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në

fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënësve; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;

- procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundërt procesit linear dhe statik të saj, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimi dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- synimet edukative të shumëfishta përkundërt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;

- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

5.1 Mjedisi i të nxënit të qytetarisë demokratike

Edukimi për qytetari demokratike nxit dhe nxitet nga një mjedis të nxëni demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Edukimi për qytetari demokratike zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Edukimi për qytetari demokratike duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetë shprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe e të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike; duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave; duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës me kritereve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të të drejtës për të shfrytëzuar ICT në fushën e edukimit për qytetari demokratike; duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjësishë shoqërore;

Nxënësit me nevoja të veçanta

Programi i lëndës së qytetarisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënëit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënëit të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënëit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënëit, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënëit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënëit brenda dhe jashtë shkollës.

5.2 Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësive qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin.

Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënësve në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendje hapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

- Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Lënda e qytetarisë duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, lënda e qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

Shembuj

I. Historia dhe qytetaria

Lënda e historisë dhe ajo e qytetarisë kanë të përbashkët:

- Konceptet: për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
- Aftësitë dhe shprehjet: për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj.

Qytetaria:

- u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe qytetarisë?

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuar në lëndën e historisë në kurrikulën e qytetarisë me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimit;
- Të lidhet me kurrikulën e qytetarisë.

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të qytetarisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm:

- Konceptet: Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj.) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- Tema: Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- Fusha kurrikulare: Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- Përmasa vendore: historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

II. Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe qytetaria

1. Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe qytetaria? Ato kanë të përbashkët:

- Konceptet: të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.;

- Përmbajtjen: bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj;
- Temat: strehimi, komunikimi etj.

2. Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së qytetarisë:

- Ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë;
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale;
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë;
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. Në ç 'mënyrë lënda e qytetarisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë? Qytetaria:

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to.
- Ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë.
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme.
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

5.3 Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Programi i lëndës së qytetarisë zhvillohet në 35 orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë, për secilën klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e

programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Koha mësimore që i kushtohet njohurive të reja dhe që duhet të mbahet parasysh nga autorët e teksti është rreth 60%.

5.4 Vlerësimi në lëndën e edukimit qytetar: njohuritë, aftësitë dhe prirjet qytetare

Standardet e përmbajtjes së lëndës së edukimit qytetar përfshijnë tri elemente të ndërlidhur me njëri tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale dhe ato të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marrë së bashku këta elementë përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementëve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen në pyetjet të tilla si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? Etj.

Aftësitë intelektuale dhe ato pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend. Aftësitë intelektuale aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet si dhe të vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike. Aftësitë pjesëmarrëse aftësojnë qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe atë qytetare duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, kërkuar konsensus, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Elementi i tretë janë prirjet qytetare që quhen ndryshme edhe “prirje të zemrës” dhe që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike. Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë;
- për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor;
- për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit;
- për t’iu bindur “rregullave të lojës”, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve;
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme;
- për të nxitur dhe mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

5.4.1 Aftësitë intelektuale

Këto aftësi mund të ndahen ose grupohen si vijon:

1. Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar.
2. Aftësia për të shpjeguar dhe analizuar.
3. Aftësia për të vlerësuar, marrë dhe mbrojtur qëndrime të caktuara.

1. Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar

- Të identifikosh do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (për shembull ministrat ose jo të prekshme (për shembull koncepte të tilla si drejtësia, barazia etj.). Të identifikosh diçka do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.

- Të përshkruash do të thotë dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

Pra të identifikosh ose të përshkruash në fushën e edukimit qytetar, për shembull, do të thotë:

- Të identifikosh koncepte kryesore të demokracisë si kushtetuta, qeverisje demokratike etj..
- Të dallosh për shembull: degët kryesore të pushtetit, format e ndryshme të qeverisjes, institucionet qeveritare nga ato joqeveritare etj.
- Të identifikosh individë, simbole, institucione si udhëheqës të shquar, simbole kombëtare etj.
- Të identifikosh ide dhe koncepte si: të drejtat e fëmijëve, të grave, shoqëri civile, patriotizëm etj.
- Të përshkruash funksione dhe procese si kontrolli ligjor i pushtetit, hartimi i politikës arsimore etj.
- Të identifikosh origjinën historike, për shembull të ditëve të caktuara historike ose të festave kombëtare, si 7 dhe 8 marsi, dita e të drejtave të fëmijës etj.
- Të klasifikosh sipas tipareve për shembull demokracia liberale, demokracia jo liberale etj.
- Të përshkruash prirjet për shembull, të pjesëmarrjen e njerëzve në votim, shkallën e emigrimit të inteligjencës shqiptare, ndikimin e kulturës evropiane në atë shqiptare përmes emigrantëve etj.

2. Aftësia për të shpjeguar dhe analizuar

- Të shpjegosh do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, për shembull, shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.
- Të analizosh do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

Pra të shpjegosh ose të analizosh në fushën e edukimit qytetar, për shembull, do të thotë:

- Të shpjegosh funksionimin e gjërave për shembull, të sistemit elektoral.
- Të analizosh arsyet për veprime, ngjarje ose prirje të caktuara, për shembull, të miratimit të ligjit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në disa zona, të rënies së shkallës së pjesëmarrjes së njerëzve në procesin e votimit etj.
- Të shpjegosh shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve dhe dukurive, për shembull, të ligjit të heqjes së dënimit me vdekje në Shqipëri etj.
- Të analizosh arsyet ose motivet, për shembull, për përdorimin e gjuhës së emocioneve, veçanërisht gjatë fushatave elektorale etj.
- Të krahasosh për shembull shkallën e mbrojtjes së interesave të minoriteteve në demokracitë liberale dhe në ato jo liberale etj.
- Të interpretosh kuptimin ose rëndësinë e ngjarjeve, të ideve ose të dukurive, për shembull, të miratimit të një ligji të caktuar, të kalimit në sistemin 9-vjeçar të arsimit të detyruar etj.

3. Aftësia për të vlerësuar, marrë dhe mbrojtur qëndrime të caktuara

Këto aftësi janë të rëndësishme pasi i ndihmojnë qytetarët të vlerësojnë çështje të jetës qytetare, të gjykojnë për to dhe të diskutojnë me të tjerët për qëndrimet e tyre.

- Të vlerësosh do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar për shembull për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.
- Të marrësh një qëndrim të caktuar do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.
- Të mbrosh një qëndrim të caktuar do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Pra, të vlerësosh, të marrësh ose të mbrosh një qëndrim të caktuar do të thotë:

- Të sfidosh argumente që vlerësohen si jo të arsyeshëm për shembull, përdorimi i emrave fyës, sulmet personale, nënkuptimet etj.
- Të vlerësosh vlefshmërinë e agreementeve, të analogjive dhe të dhënave, për shembull, burimet e të dhënave, kohezioni logjik, përdorimi i duhur i analogjive etj.
- Të japësh të dhëna për të mbështetur ose hedhur poshtë, për shembull, besueshmëria e fakteve, përshtatshmëria e fakteve, kontradiktat ndërmjet llojeve të ndryshme të të dhënave etj.
- Të parashikosh pasojat e mundshme, për shembull, vlera e parashikimit, shkalla e mundësisë, krahasimi i me shembuj të të kaluarës etj;
- negativisht, kosto monetare përkundrejt vlerave shoqërore;
- Të zgjedhësh një qëndrim të caktuar nga alternativat ekzistuese, për shembull, analiza e qëndrimeve ekzistuese, gjykimi i qëndrimeve duke përdorur kriteret e duhura;
- Të krijosh një qëndrim të ri, për shembull, të dallosh idetë më të mira nga alternativat ekzistuese, harmonizimi i elementeve përbërëse në një mënyrë të caktuar;
- Të mbrosh një qëndrim të caktuar, për shembull, përputhja me vlerat dhe parimet themelore, kosto që nuk mbështetet ose kalohet nga fitimi, alternativa më e mirë ose më e keqe e kundërshtueshme etj.
- T'u përgjigjesh argumenteve të kundërta, për shembull citimi i argumenteve të përshtatshme, kundërshtimi i gjuhës së emocioneve etj.; marrja parasysh e rastit më të mirë që kundërshton pikëpamjet personale.

5.4.2 Aftësitë pjesëmarrëse

Këto aftësi vlerësohen shumë të rëndësishme për të pasur qytetarë të mirinformuar, të efektshëm dhe të përgjegjshëm. Ato mund të grupohen si aftësi që lidhen me ndërveprimin, monitorimin dhe ndikimin. Kjo do të thotë se edukimi për qytetarinë demokratike nuk duhet të trajtojë vetëm çështjet fitimit të njohurive dhe të aftësive intelektuale, por edhe të çështjeve që lidhen me zhvillimin e aftësive të nevojshme për të patur një pjesëmarrje cilësore dhe të përgjegjshme në proceset politike dhe në shoqërinë civile.

Grupimet e mëposhtme kanë të bëjnë me aftësi të qytetarit për të bashkëvepruar me efektshmëri me të tjerët në një kontekst të caktuar politik ose shoqëror.

- A. Ndërveprimi ka të bëjë me aftësitë që u nevojiten qytetarëve për të komunikuar dhe bashkëvepruar me të tjerët. Të ndërveprosh do të thotë të jesh i përgjegjshëm për të tjerët. Të ndërveprosh do të thotë të pyesësh, të përgjigjesh, të marrësh vendime qytetare, të ndërtosh koalicione, të menaxhosh konflikte në mënyrë paqësore dhe të drejtë.
- B. Mbikëqyrja e politikës dhe e qeverisjes nënkupton aftësitë që u nevojiten qytetarëve për të ndjekur menaxhimin e çështjeve nga proceset politike dhe nga qeveria. Të mbikëqyrësh veprimtarinë e qeverisë dhe menaxhimin e çështjeve publike është thelbësore për një pjesëmarrje qytetare cilësore dhe të mençur.
- C. Të ndikosh do të thotë të jesh i pajisur me aftësitë e nevojshme për të ndikuar proceset politike dhe qeverisëse në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal ose komuniteti.

Të ndërveprosh do të thotë të jesh i aftë të punosh në grupe të vogla dhe komitete, të mbledhësh informacion, të shkëmbelesh opinione, të hartosh plane veprimi;

Të mbikëqyrësh politikën dhe qeverisjen ka të bëjë me aftësitë e qytetarëve për të ndjekur në proces trajtimin e çështjeve të ndryshme nga qeveria dhe vetë procesi politik. Mbikëqyrja e veprimtarisë së qeverisë ka rëndësi për qytetarin që dëshiron të marrë pjesë në mënyrë të kualifikuar në çështjet politike.

Të ndikosh, do të thotë të kesh aftësitë e duhura për të ndikuar proceset e politikës dhe të qeverisjes sinë nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal.

A. Ndërveprimi

Të ndër veprosh do të thotë të jesh i aftë:

- Të punosh në grupe të vogla, të mbledhësh informacion, të shkëmbesh opinione, të hartosh plane veprimi.
- Të dëgjosh, të mbledhësh informacion, ide dhe këndvështrime të ndryshme.
- Të diskutosh për çështje të interesit publik në mënyrë të mirë informuar, të përgjegjshme dhe qytetare në shkollë, në lagje, në bashkësi, me shokët, me fqinjët etj.
- Të ndërtoosh koalicione me individë ose grupe që ndajnë të njëjtat pikëpamje për të nxitur politika dhe kandidatë që do t'i vënë ato në jetë.
- Të menaxhosh konfliktet përmes ndërmjetësimit, negociimit, kompromisit, konsensusit etj.
- Të kryesh shërbime në shkollë dhe në komunitet, si përfaqësues ose drejtues i zgjedhur, të organizosh forume për çështje publike, të punosh me organizata të ndryshme etj.
- Të përdorësh burimet e medias për të marrë informacion, për të shkëmbyer ide dhe për të mbrojtur ose përkrahur politika të caktuara publike.
- Të diskutosh për çështje publike si kujdesin shëndetësor, punësimin, mjedisin etj.
- Të vlerësosh argumentet dhe qëndrimet e të tjerëve për vlefshmërinë e tyre dhe jo për personin që i shpreh ato.
- Të qëndrosh i qetë ndaj pikëpamjeve të kundërta me të tuat etj.

B. Mbikëqyrja

Të mbikëqyrësh do të thotë të jesh i aftë:

- Të dëgjosh me kujdes qytetarët e tjerë, funksionimin e organizmave publikë dhe raportet e medias.

- Të pyesësh zyrtarët, ekspertët dhe të tjerët për të marrë informacion dhe përcaktuar përgjegjësitë.
- Të ndjekësh çështje publike në media, duke përdorur burime të ndryshme informacioni, si bibliotekën, telefonin, radion, TV, gazetat etj.
- Të mbledhësh dhe të analizosh informacionin e marrë nga qeveritarët dhe institucionet qeveritare, grupet e interesit, organizatat e ndryshme etj.
- Të ndjekësh takimet publike, për shembull, këshillat e nxënësve, të bashkësisë, bordet e shkollës etj.
- Të intervistosh njerëz të njohur për çështjet qytetare.
- Të përdorësh burime elektronike për të marrë dhe shkëmbyer informacion.

C. Ndikimi

Të ndikosh do të thotë të jesh i aftë:

- Të informosh të tjerët, për shembull t'u japësh të dhëna faktike për çështje të ndryshme qeveritarëve, hartuesve të ligjeve etj.;
- Të bësh peticione, d.m.th. të tërheqësh vëmendjen e organeve përfaqësuese për ankime ose ndryshime të mundshme të dëshiruara në fushën e politikës publike, të mbledhësh firma etj.;
- Të shkruash letra që trajtojnë çështje të interesit të përbashkët;
- Të flasësh dhe të dëshmosh përpara organeve publike;
- Të përkrahësh ose të kundërshtosh kandidatë ose qëndrime të ndryshme që lidhen me çështje publike;
- Të marrësh pjesë në jetën qytetare dhe në grupe politike, për shembull, në qeveri studentore etj.;
- Të përdorësh pikëpamjet më të përparuara të medias për çështjet publike, për shembull, duke marrë pjesë në diskutime të çështjeve publike, duke shkruar artikuj në gazeta ose revista, duke shfrytëzuar radion ose programet televizive për të shprehur opinionin për çështje të interesit të përbashkët etj.

5.4.3 Prirjet qytetare

Këto kanë të bëjnë me ato elemente të karakterit personal dhe publik që janë thelbësore për ruajtjen dhe zhvillimin e demokracisë.

Këto prirje zhvillohen ngadalë, si rrjedhojë e procesit të të nxënimit dhe të përvojës që individi fiton në jetën e tij në familje, në shkollë, në bashkësi dhe gjatë pjesëmarrjes së tij në jetën qytetare. Në këtë proces, dhe përmes këtyre përvojave individi arrin në përfundimin se demokracia kërkon përgjegjësinë e vetëqeverisjes së secilit dhe se askush nuk mund të ekzistojë pa tjetrin. Tiparet e karakterit personal të individit të tilla si përgjegjësia morale, vet disiplinë, respekti për vlerat e individit dhe të dinjitetit njerëzor janë thelbësore për mirëqenien e shoqërisë dhe të demokracisë.

Demokracia nuk mund t'i plotësojë qëllimet e saj nëse qytetarët nuk janë të prirur të marrin pjesë tërësisht në jetën publike të shoqërisë. Tiparet e karakterit publik të tilla si gjallëria qytetare, qytetari, respekti për ligjin, mendja kritike dhe vullneti për të dëgjuar, për të biseduar, për të arritur kompromise janë të domosdoshme për mirëqenien e shoqërisë.

Prirjet qytetare që ndihmojnë në efektshmërinë politike të individit, funksionimi i shëndetshëm i sistemit politik, ndjenja e dinjiteti dhe e vlerës dhe e mira e përgjithshme përfshin:

1. Qenien si një anëtar i pavarur i shoqërisë, që do të thotë:

- të marrësh pjesë vullnetarisht në standarde sjelljeje të vetëvendosura në vend të kërkesës për t'iu bindur kontrolleve nga jashtë;
- të pranosh përgjegjësinë e pasojave të tua;
- të plotësosh detyrimet morale dhe ligjore të anëtarit të shoqërisë.

2. Marrjen përsipër të përgjegjësisë personale, politike dhe ekonomike të një qytetari, që do të thotë:

- të kujdesesh për veten.
- të mbështetësh familjen tënde dhe të kujdesesh për mirëqenien dhe edukimin e fëmijëve të tu.

- të jesh i mirinformuar për çështjet publike, të votosh, të kryesh shërbime të ndryshme në bashkësi etj.

3. Respektimin e vlerave individuale dhe të dinjitetit njerëzor që do të thotë:

- të trajtosh secilin me respekt,
- të dëgjosh mendimin e të tjerëve,
- të marrësh parasysh të drejtat dhe interesat e të tjerëve,
- të pranosh parimin e sundimit të shumicës,
- të respektosh të drejtat e minoriteteve etj.

4. Pjesëmarrjen në çështjet qytetare duke qenë i mirinformuar, në mënyrë të arsyeshme dhe qytetare që do të thotë:

- të informohesh përpara se të votosh ose të marrësh pjesë në një debat publik,
- të marrësh përsipër drejtimin kur kërkohet,
- të vlerësosh nëse dhe kur është e domosdoshme që dëshirat dhe interesi personal t'i nënshtrohen interesit të përgjithshëm,
- të vlerësosh nëse dhe kur detyrimet morale ose parimet kushtetuese kërkojnë heqjen dorë nga disa kërkesa qytetare.

5. Nxitjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të demokracisë në vend, që do të thotë:

- të jesh gjithmonë i informuar dhe i vëmendshëm ndaj çështjeve publike;
- të njohësh parimet e demokracisë;
- të monitorosh shkallën në të cilën veprimtaria e politikanëve dhe e institucioneve qeveritare përputhet me parimet kushtetuese dhe të marrësh masat e duhura në rast se mungon kjo përputhje;
- të përpiqesh në rrugë paqësore dhe të ligjshme për të ndryshuar ligjet që mendohen të papërshtatshme ose të padrejta.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse me parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.

6 MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Ueb për njohuri për shoqërinë;
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion;
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm softueri;
- Përdorimi i simulimeve softuerë;
- Përdorimi i grafikëve softueri;
- Paraqitja grafike e të dhënave.